



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkia Divjakë”

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Auditim Financiar

Tiranë, Tetor 2024

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.....	7
II. HYRJA	8
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.	8
1. Objektivat dhe qëllimi.....	8
2. Identifikimi i çështjes.....	8
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	9
4. Përgjegjësitë e audituesve.	9
5. Kriteret e vlerësimit	10
6. Standardet e auditimit.....	11
7. Metodatat e auditimit	12
8. Dokumentimi i auditimit.....	13
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Divjakë”	13
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	14
2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	14
2.2. Burimi i krijimit i të të ardhurave dhe mbledhje e tyre	25
2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.....	36
2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM.....	58
IV. REKOMANDIME.....	62
D. MASA DISIPLINORE	71
V. ANEKSET.....	Error! Bookmark not defined.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Divjakë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Divjakë për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

a. Për vitin 2023 nga Bashkia Divjakë janë shpenzuar gjithsej 534,110 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 323,132 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 122,934 mijë lekë; për investime në vlerën 88,044 mijë lekë.

b. Për vitin 2023 Bashkia Divjakë nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithsej vlerën 157,004 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:

Auditimi i këtij institucioni merr rëndësi për arsye se administron, menaxhon dhe shpenzon, fonde të miratuar nga Këshilli Bashkiak Divjakë, me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
- Burimi i krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike të transferuara sipas VKM.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që

vlerësohen me nivel të lartë rrisht. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në rrishtun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 8,653 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën në auditimi paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 18 gjetje dhe ka dhënë 20 rekomandime, nga ku masa organizative me 14 gjetje dhe 15 rekomandime, masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore 3 gjetje dhe 4 rekomandime në vlerën 552,971,435 lekë dhe masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara për administrimin e fondeve publike 1 gjetje dhe 1 rekomandim.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifikën ka vlerën 634,502 mijë lekë, buxheti i rishikuar ka vlerën 716,523 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 534,110 mijë lekë ose në masën 74%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 362,218 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 323,132 mijë lekë ose në masën 89%. Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 217,758 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 70,573 mijë lekë ose në masën 72%. Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 122,906 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 88,044 mijë lekë ose në masën 56 %. Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230*231) është planifikuar në vlerën 301,704 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 145,883 mijë lekë ose në masën 71%.

- Bashkia Divjakë në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 32,407 mijë lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim vlera 32,407 mijë lekë. Gjatë vitit 2023 është likuiduar vlera prej 31,228 mijë lekë për detyrimet e prapambetura dhe ka mbetur për likuidim vlera 1,179 mijë lekë.

Detyrime të reja të krijuara janë në vlerën 34,305 mijë lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura të raportuara nga Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit janë në vlerën 35,484 mijë lekë. Nga këto detyrimet të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta janë në vlerën 7,003 mijë lekë dhe detyrimet të prapambetura me burim financimi nga Buxheti i Shtetit janë në vlerën 28,481 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024 në bazë të kontrata të investimeve nga vitet e mëparshme dhe faturat tatimore të pranuar, Bashkia Divjakë ka detyrim vlerën 40,958,464 lekë.

- Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën **230,126 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **157,004 mijë lekë** ose në masën

68% me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **73,122 mijë lekë**.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Divjakë më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 28,558,958 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 27,183,201 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Për 28 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Divjakë janë ngurtësuar fonde në vlerën 5,175,262 lekë për të cilat nuk është bërë zhblokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Lushnje, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës

-Në gjendjen e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” janë përfshirë tre aktivet me emërtimin “Rikonstruksion lulishte nr.1” me kosto historike 299,400 lekë, “Rikonstruksion lulishte nr.2 Grabian” me kosto historike 398,246 lekë, “Lulishte tregu javor” me kosto historike 1,856,026 lekë aktivet duhej të klasifikoheshin në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione.

-Për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023, Bashkia Divjakë ka shpenzuar vlerën 3,803,429 lekë e cila i përket vendimit nr. 397, datë 05.02.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit.

- Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Divjakë konstatohet se deri më datën 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën 495,548,079 lekë shumë e cili i përket vetëm abonentëve familjarë.

Detyrimet e tatimpaguesve biznes që kanë ndaj Bashkisë Divjakë konstatohet se deri në datë 31.12.2023, borxhi tatimor është në vlerën 39,555,247 lekë dhe i përket 299 bizneseve.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që:

Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifatat vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të Bashkisë Divjakë.

Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifatat vendore të vitit buxhetor aktual.

- Sektori i Ujitjes dhe Kullimit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për “Tarifën e Ujitjes”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 113,200 lekë ndaj 51 debitorëve.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë, të marrë masa për hartimin e regjistrimit të tatimpaguesve fizik/juridik/shtetërorë dhe abonentët familjarë më të gjitha detyrime vjetore që ato kanë në zbatimin të paketës fiskale të miratuar çdo vit.

- Drejtoria e Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes të marrë masa për krijimin e regjistrimit të fermerëve, regjistrin për sasinë e ujit ose numrin e ujitjeve të përfituara nga fermerët
- Nëpunësi zbatues të marri masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 11.2% në kapitalin e aksioneve tek “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lushnje” Sh.a me vlerë 1,112,000 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
- Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.
- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 2,553,672 lekë me kosto historike për aktivet, “Rikonstruksion lulishte nr.1”, “Rikonstruksion lulishte nr.2 Grabian”, “Lulishte tregu javor” së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur, duke e pakësuar si aktiv nga llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe duke e kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.
- Kryetari i Bashkisë Divjakë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve në llogaritë . 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësisish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.
- Bashkia Divjakë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e duhura për paraqitjen reale të llogarisë 401-408, duke kontabilizuar vlerën 392,120,451 lekë me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj.
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë 17,268,109 lekë ndaj 319 personave.
- Bashkia Divjakë, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimin tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore deri më datën 31.12.2023, në vlerën totale 535,103,326 lekë e cila përbëhet nga:
 - 495,548,078 lekë detyrime nga abonentët familjarë;
 - 39,555,247 lekë detyrime nga biznesi;
 - a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
 - b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
 - c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
 - d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Tatim Taksave të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
 - e. Sektori i Tatim-Taksave të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Divjakë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

Për drejtimin e Bashkisë Divjakë mbi auditimin e pasqyrave financiare:

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Divjakë për vitin ushtrimor nga 01.01.2023 - 31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të konsoliduara të subjektit Bashkia Divjakë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**", e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 10,682 mijë lekë.

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

-Llogaria 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 21,049,578 lekë.

-Llogaria 231 "Investime" është paraqitur e nënvlerësuar në pasqyrat e pozicionit financiar për vlerën 5,846,966 lekë, si pasojë e kontabilizimit në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstrukione" e investimeve në proces.

-Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" është paraqitur e nënvlerësuar në bilanc për vlerën 389,620,451 lekë për detyrimet e projekteve të investimit për të cilët janë pranuar faturat tatimore.

-Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 2,553,672 lekë, kjo

vlerë e përbërë nga 3 aktive duhet të kontabilizohet në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione”.

-Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 2,041,769 lekë këto aktive duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

-Llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksiione” është paraqitur e mbivlerësuar për vlerën 3,293,294 lekë si pasoje e kontabilizime jo të sakta në llogaritë 210 “Toka, troje, terrene” dhe llogarisë 231 “Investime”.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 752/1prot., datë 07.06.2024 “*Auditim financiar në Bashkinë Divjakë*”, i ndryshuar nr. 752/2 prot, datë 08.07.2024 të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 12.06.2024 – 10.07.2024, në subjektin Bashkia Divjakë për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 - 31.12.2023, u krye “*Auditim Financiar*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K.H, *Auditues i parë, Përgjegjës Grupi,*
2. A. D, *Auditues i parë, anëtar;*
3. E. S, *Audituese e dytë, anëtarë;*

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Raporti përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Divjakë.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Divjakë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj

komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Divjakë.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Divjakë (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Divjakë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.¹

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Divjakë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë,

¹ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, neni 15

Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Divjakë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 84/2022 “*Për buxhetin e vitit 2023*”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “*Për përgatitjen e buxhetit vendor*”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “*Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023*”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”. Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2022 “*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025*”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr. 248, date 10.4.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet*

shitetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njërive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*” .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave lokale*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “*Për taksat kombëtare*”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.09.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “*Për pagat e vetëqeverisjes Vendore*”, i ndryshuar.

- Në fushën e administrimit e pronës publike: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë*”, VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “*Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave të Bashkisë*”.

6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm*”; INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përrputhshmërisë*” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përrputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampionëve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*². Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashë normale*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

² *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 4 akt konstatime. Nga ana e Bashkisë Divjakë janë paraqitur pretendime në lidhje me aktet e mbajtura duke vijuar me hartimin e Projekt Raportit të Auditimit dhe Informacionit përmbledhës. Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 973/5, datë 08.03.2024. Nga ana e Bashkisë Divjakë me shkresën nr. 4726/10, datë 27.08.2024 është dërguar konfirmimi i marrjes së projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Divjakë”

Zona Gjeografike: Bashkia Divjakë kufizohet në veri me Bashkinë Rrogozhinë, në lindje me Bashkinë Lushnje, në jug me Bashkinë Fier dhe në perëndim me detin Adriatik. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Divjakës. Bashkia Divjakë ka 4 njësi administrative si: NJA Gradisht, NJA Tërbuf, NJA Grabian dhe NJA Remas.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2024 ka një popullsi prej 24,882 banorësh. Bashkia Divjakë shtrihet në një sipërfaqe prej 309,58 km² me një densitet prej 80.37 banorë/km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e Divjakës përbëhet pothuajse tërësisht nga zona rurale dhe ka një shtrirje veri-jug ndërkohë që rrugët janë më së shumti në drejtimin lindjeperëndim. Një pjesë e territorit të kësaj bashkie është parku kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe plazhi i Divjakës. Bashkia ka aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe në një masë më të vogël peshkimin në lagunën e Karavastasë. Prodhimi kryesor bujqësor janë bostanët, të cilat shiten në tregun e

brendshëm si dhe eksportohen në shumë vende të Europës qendrore dhe lindore. Divjaka ka perspektivë të mirë për zhvillimin e turizmit detar si dhe ekoturizmit. Gjatë viteve të fundit është shfaqur turizmi i vrojtimit të zogjve për shkak të pranisë së një kolonie të vogël pelikanësh në zhdukje në lagunën e Karavastasë

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Divjakë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Divjakë për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me akt rakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

2.1.4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, çelja e fondeve dhe realizimi i tyre.

2.1.5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, raportit i tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në MF ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve të FZHR dhe Ministrive të linjës etj.).

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA 2023-2025 auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Divjakë për shpenzimet dhe të ardhurat;
4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendimeve gjyqësore;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimet të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj).
9. Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.

2.1.1. Programimi PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023:

Me shkresën nr. 1255/9, datë 18.03.2022, Titullari i Bashkisë Divjakë ka dërguar pranë Këshillit Bashkiak për miratim, Tavanet Përgatitore të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afat Mesëm 2023-2025. Tavanet përgatitore janë miratuar me VKB nr. 13, datë 23.03.2022 “Tavanet përgatitore të shpenzimeve për PBA-në 2023-2025 për Bashkinë Divjakë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 337/1 prot, datë 30.03.2022.

Udhëzimi i brendshëm për përgatitjen e PBA-së 2023-2025 është hartuar me shkresën Nr. 142, datë 11.04.2022 në kundërshtim me udhëzimin për përgatitjen e PBA 2023-2025. Në udhëzimin e brendshëm është paraqitur lista e programeve buxhetore dhe përcaktimin e ekipeve përkatëse të menaxhimit të programeve. Janë përcaktuar afate të detajuara për Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për përgatitjen e kërkesave të shpenzimeve sipas programeve të PBA-së 2023-2025.

Faza e parë e PBA-së është miratuar në Këshillin Bashkiak me VKB nr. 22 datë 27.06.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 672/1 Prot, datë 06.07.2022, si dhe dërguar për mendim pranë MFE me shkresën nr. 2509, datë 02.06.2022.

Tavanet përfundimtare janë miratuar me VKB nr. 29 datë 22.07.2022 “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm Vjetor 2023-2025”.

PBA 2023-2025 është miratuar me VKB nr. 66, datë 23.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 1323/3 Prot, datë 12.01.2023.

Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korente, ashtu edhe për investimet dhe të ardhurat.

Nga auditimi i procesit të hartimit të PBA-së dhe dokumentimit të hapave të ndjekura rezultoi se:

1. Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave i cili miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 01.03.2022.

2. Tavanet përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve;
 3. Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP) nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatori i GMS, brenda muajit prill 2022. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet.
 4. Nga Bashkia Divjakë nuk janë organizuar takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.
- Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2022 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”.

Tabela 1: Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Planifikimi, Menaxhimi, Administrimi	280,468	45	276,615	44.5	281,000	45
2	Shërbimet e Policisë Vendore	4,497	0.7	9,200	1.4	9,831	1.5
3	Mbrojtja nga zjarri dhe Mbrojtja civile	16,572	2.6	13,972	2.2	13,972	2.2
4	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	22,185	3.5	17,000	2.7	25,000	4
5	Shërbime Bujqësore, Inspektimi, Siguri Ushqimore, Mbrojtja Konsumatorëve	0	0	0	0	0	0
6	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujtit dhe kullimit	33,768	5.4	35,407	5.6	32,407	5.1
7	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	1,366	0.2	966	0.1	966	0.1
8	Rrjeti Rrugor Rural	66,555	10.7	68,403	11	56,415	9
9	Transporti Publik	0	0	0	0	0	0
10	Menaxhimi i Mbetjeve	4,000	0.6	4,000	0.6	4,000	0.6
11	Planifikimi Urban Vendor	0	0	0	0	0	0
12	Shërbimet Publike Vendore	107,661	17.4	117,516	18.9	119,488	19.1
13	Furnizimi me ujë dhe kanalizimi	0	0	0	0	0	0
14	Shërbimet e Kujdesit Parësor	0	0	0	0	0	0
15	Sport dhe Argëtim	2,236	0.3	4,000	0.6	6,500	1
16	Trashëgimia Kulturore, Eventet artistike dhe kulturore	1,968	0.3	4,000	0.6	4,562	0.7
17	Arsimi Bazë përfshirë parashkollorin	91,126	14.7	87,972	14.1	87,972	14
18	Arsimi i Mesëm dhe i përgjithshëm	2,100	0.3	1,410	0.2	1,410	0.2
19	Përkujdesi Social	0	0	0	0	0	0
20	Strehimi Social	0	0	0	0	0	0
	Totali	618,322		621,247		624,217	

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Në miratimin e taveve buxhetore janë përfshirë edhe parashikimi për fondin e kontigjencës dhe fondin rezervë për vitet 2023- 2025 si më poshtë.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Fondi rezervë	9,835	1.6	10,247	1.6	12,870	1.6
2	Fondi i Kontigjencës	6,345	1	8,966	1.4	6,435	1

Burimi: Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 2: Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
--	-----------------------------	-----------	-----------	-----------

N r		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	Paga (600)	288,524	45	256,521	40	254,640	39.5
2	Sigurime (601)	48,140	7.8	51,445	8	51,050	7.9
3	Shpenzime operative (602)	183,943	29	189,579	29	205,672	31.9
4	Shpenzime (603)	-	-	-	-	-	-
5	Shpenzime (604)	16,261	2.5	20,000	3.1	20,000	3.1
6	Shpenzime (606)	-	-	-	-	-	-
7	Shpenzime (609)	-	-	-	-	-	-
8	Shpenzime për investime (230-231)	97,634	15.3	122,916	19.1	112,161	17.4
	Tjera...	634,502		640,461		643,523	

Burimi:Punoi Grupi i Auditimit

Tabela 3:Sipas PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:
Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2023-2025.

A	Të ardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	127,937	150,058	155,256
2	Jo tatimore	102,189	109,942	114,744
I	Totali	230,126	260,000	270,000
1	Transferta e pakushtëzuar	253,771	253,771	256,563
2	Transferta specifike	116,960	116,960	116,960
3	Të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm	33,645	9,730	-
II	Shuma e transfertave	404,376	380,461	373,523
III	Transferta te pritshme (FZHR e tjera)	-	-	-
	Totali i burimeve të veta (I +II+III)	634,502	640,461	643,523

Burimi:Punoi Grupi i Auditimit

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor

Buxheti i vitit 2023 është miratuar në Këshillin Bashkiak me VKB nr. 62, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë, dhe Ndërmarrjet vartëse të Bashkisë për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresën nr. 1323/1 Prot, datë 05.01.2023.

Sipas VKB nr.62 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2023” rezulton se të ardhurat nga burimet e vete të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën **230,126 mijë lekë**, transferta e pakushtëzuar ka vlerën **253,771 mijë lekë**, transferta specifike ka vlerën **116,960 mijë lekë**.

I detajuar planifikimi i buxhetit fillestar për vitin 2023 paraqitet në vijim:

Tabela 4:Të dhënat mbi buxhetin fillestar

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhurat	634,502	
2	Të ardhura të veta të trashëguara sipas rakordimeve me thesarin	2,452	
3	Të ardhura e vitit ushtrimorë	230,126	
4	Transferta e pakushtëzuar	253,771	
5	Transferta specifike	116,960	
6	Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	21,193	
7	Shpenzimet		634,502
8	Paga (600)		288,524
9	Sigurime (601)		48,139
10	Shpenzime (602)		183,943
11	Shpenzime (604-606)		16,261
12	Investimet (230 +231)		97,634

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
Totali i buxhetit		634,502	634,502

Burimi:Punoi Grupi i Auditimit

Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashkia+ Njësia e Varësisë Agjencia e Shërbimeve Komunale) është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **634,502 mijë lekë**.

Planifikimi i shpenzimeve kapitale për vitin 2023 është bërë si vijon:

Gjatë vitit 2023 sipas VKB Nr.65, datë 23.12.2022 janë parashikuar shpenzime kapitale në vlerën 97,634 mijë lekë të cilat do të financohen nga të ardhurat e veta dhe transferta e pakushtëzuar.

Gjatë hartimit të PBA 2023-2025 dhe Buxhetit të vitit 2023 për investimet e reja të cilat do të financohen gjatë viteve 2023-2025 nuk disponohet dokumentacioni justifikues për këto investime.

-Investime në vazhdim gjatë vitit 2023 është planifikuar të likujdohen në vlerën 34,264 mijë lekë.

Investime të reja të planifikuara gjatë vitit 2023 janë në vlerën 135,370 mijë lekë nga të cilat është planifikuar të likujdohen gjatë vitit 2023, shuma 63,370 mijë lekë, gjatë vitit 2024, 45,000 mijë lekë dhe gjatë vitit 2025 shuma 27,000 mijë lekë.

Në **aneksin nr. 2/1/5** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqitet lista e investimeve kapitale të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2023 nga të ardhurat e veta dhe granti.

2.1.2. Celja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës specifike dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësimi). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

-Në hartimin e projekt buxhetit vjetor, është marrë në konsideratë realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

-Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Lushnje dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

-Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Gjatë vitit 2023 janë miratuar disa vendime të tjera të Këshillit Bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë. Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr.13 , datë 22.02.2023 është marrë vendim nga Këshilli Bashkiak Divjakë për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 26,280,364 lekë.

- Me VKB nr.37, datë 24.07.2023 është marrë vendim nga Këshilli Bashkiak Divjakë “Mbi miratimin e një shtese fondi, për rritjen e pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale” në vlerën 3,666,518 lekë.

- Me VKB nr.45, datë 25.09.2023 është marrë vendim nga Këshilli Bashkiak Divjakë “Mbi miratimin e një shtese fondi, për rritjen e pagave për punonjësit e Bashkisë Divjakë në buxhetin e vitit 2023, në mbështetje të VKM nr.328 dt.31.05.2023” në vlerën 11,315,232 lekë.

- Me VKB nr.54 , datë 27.10.2023 është marrë vendim nga Këshilli Bashkiak Divjakë “Mbi miratimin e një shtese fondi, të transfertës së pakushtëzuar në zbatim të aktit normativ nr.5 datë 18.10.2023, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.84/2022, për buxhetin e vitit 2023 në vlerën 10,000,000 lekë.

- Me VKB nr.69, datë 26.12.2023 është marrë vendim nga Këshilli Bashkiak Divjakë “Mbi miratimin e një shtese fondi të ardhur nga MFE, në zbatim të aktit normativ nr.6 datë.14.12.2023, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” në vlerën 30,758,822 lekë.

Në **aneksin nr. 2/1/6** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqitet të dhëna përmbledhëse për planifikimin e buxhetit dhe ndryshimet për vitin 2023 sipas VKB përkatës.

Në **aneksin nr. 2/1/7** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqitet tabela e ndryshimeve të buxhetit për vitin buxhetor 2023.

2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të celura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Lushnje si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Për vitin 2023, planifikimi i buxhetit i rishikuar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën specifiken ka vlerën 716,523 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 534,110 mijë lekë, ose në masën 74%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore, shëndetësore është planifikuar në vlerën 362,218 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 323,132 mijë lekë, ose në masën 89%,

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 217,758 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 122,934 mijë lekë, ose në masën 32%.

Zëri transferta korente të brendshme është planifikuar në vlerën 13,641 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 0 lekë.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 122,906 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 88,044 mijë lekë, ose në masën 71%.

Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Divjakë së bashku me transfertat e pakushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar.

Për vitin 2023 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 716,523 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 534,110 mijë lekë, ose në masën 74 %,

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, për vitin 2023 investimet janë planifikuar në vlerën 122,906 mijë lekë, realizuar 88,044 mijë lekë, ose në masën 71%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës. Bashkia Divjakë në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikojë angazhime buxhetore realiste. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku citohet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transferata e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në **aneksin nr. 2/1/8** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Analiza e mësipërme e buxhetit të Bashkisë Divjakë është kryer pa përfshirë fondet e kushtëzuara nga buxheti i shtetit. Duke përfshirë edhe fondet e kushtëzuara do të kemi ndryshim të buxhetit të Bashkisë Divjakë. Planifikimi i buxhetit i rishikuar duke përfshirë edhe fondet e kushtëzuara është në vlerën 999,371 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 810,271 mijë lekë, ose në masën 81%.Gjatë vitit 2023 Bashkia Divjakë ka përfituar fonde të kushtëzuar në vlerën 276,173 mijë lekë me të cilat janë financuar zërat e shpenzimeve si mëposhtë.

Me fondet e kushtëzuar janë financuar shpenzimet kapitale (artikulli 230 dhe 231) në vlerën 28,644 mijë lekë.

Për funksionet e deleguara të transferuara sipas ligjit për vetëqeverisjes vendore nr. 139/2015, datë 17.12.2015 janë financuar pagat dhe sigurimet shoqërore shëndetësore në shumën 4,956 mijë lekë. Buxheti i Shtetit gjatë vitit 2023 në Bashkinë Divjakë ka mbuluar shpenzimet për ndihmë ekonomike dhe pagesat për personat me aftësi të kufizuar në vlerën 233,291 mijë lekë.

Referuar të dhënave të mësipërme Bashkia Divjakë ka nivel të ulët përftimi fondesh për investime kapitale të financuara nga buxheti i shtetit.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin duke përfshirë edhe fondet e kushtëzuara paraqitet në **aneksin nr. 2/1/9** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit

Referuar buxhetit faktik për vitin 2023 niveli i shpenzimeve për Bashkinë Divjakë është në vlerën 810,283 mijë lekë. Këto shpenzime janë financuar nga të ardhurat e veta në shumën 134,754 mijë lekë, nga transferata e pakushtëzuar në vlerën 390,356 mijë lekë, nga transferata sektoriale në vlerën 13,596 mijë lekë, nga transferata e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 238,422 mijë lekë dhe nga transferata e kushtëzuar për investime në vlerën 24,155 mijë lekë.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023, sipas burimeve të financimit paraqitet në **aneksin nr. 2/1/10** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë.

Për vitin 2023, periudha Janar-Dhjetor ky fond është planifikuar në vlerën 16,261 mijë lekë. Fondi rezervë dhe i kontigjencës është përdorur për pagesë qiraje për familjet e pastreha, ndihmë ekonomike familjeve në nevojë, për bursa për studentët, rimbursim i invalidëve për transport urban, në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2020 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së

ndihmës shtetërore financiare”.

Më poshtë gjenden VKB për përdorimin e fondit të emergjencave civile dhe fondin rezervë:

1. Me lëvizjen e fondeve nr.802 prot datë 14.02.2023, duke u mbështetur në VKB nr.58 datë 23.12.2022 "Mbi miratimin për familjet në nevojë për dhënien e ndihmave ekonomike të menjëhershme" dhe VKB nr.61 datë 23.12.2022 "Mbi përdorimin e fondit rezervë për shpërblimin e maturantëve me notë mesatare 9.5-10 për vitin shkollor 2021-2022". Zvogëlohet fondi rezervë 04980(01) me vlerën 360,000 lekë dhe shtohet programi 10430 (01) në vlerën 360,000 lekë.

2. Me lëvizjen e fondeve nr.803 prot datë 14.02.2023, duke u mbështetur në VKB nr.3 datë 27.01.2023 "Mbi miratimin për familjet në nevojë për dhënien e ndihmave ekonomike të menjëhershme" dhe VKB nr.4, datë 27.01.2023 "Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qera në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar vlerën e qerasë". Zvogëlohet fondi i emergjencës 03280(01) me vlerën 20,000 lekë dhe fondi rezervë 04980(01) me vlerën 110,000 lekë dhe shtohet programi 10430 në vlerën 130,000 lekë (01).

3. Me lëvizjen e fondeve nr.1209, prot datë 10.03.2023, duke u mbështetur në VKB nr.4, datë 27.01.2023 "Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qera në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshëm për të përballuar vetë vlerën e qerasë". Zvogëlohet fondi i emergjencës 03280(01) me vlerën 100,000 lekë dhe shtohet programi 10430 në vlerën 100,000 lekë (01).

4. Me lëvizjen e fondeve nr.1210 prot, datë 10.03.2023, duke u mbështetur në VKB nr.11 datë 22.02.2023 "Mbi miratimin për familjet në nevojë për dhënien e ndihmave ekonomike të menjëhershme. "Zvogëlohet fondi rezervë 04980(01) me vlerën 370,000 lekë dhe shtohet programi 10430 në vlerën 370,000 lekë (01).

5. Me lëvizjen e fondeve nr.2767 prot, datë 22.05.2023, duke u mbështetur në VKB nr.8 datë 27.01.2023 "Për rimbursimin e invalidëve për 1 vit në Ligjin nr.8303, datë 19.03.1998, për transportin rrugor i ndryshuar ". Zvogëlohet fondi rezervë 04980(05) me vlerën 400,000 lekë dhe shtohet programi 10430 në vlerën 400,000 lekë (05).

Tabela 5 :Të dhënat mbi përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës:

Planifikimi vjetor				Realizimi		
2023	Plan 01	Plan 05	Plan Total	1	5	Totali
Fondi Emergjencës	6,761,000	1,000,000	7,761,000	120,000		120,000
Fondi Rezerve	3,000,000	5,500,000	8,500,000	1,510,000	400,000	1,910,000
Totali	9,761,000	6,500,000	16,261,000	1,630,000	400,000	2,030,000

Burimi: Bashkia Divjakë

Raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit

Raporti i monitorimit i zbatimit të buxhetit të periudhës Janar - Prill 2023 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 3025 prot, datë 08.06.2023.

Raportimi i periudhës Janar- Prill:

Plan Buxheti Bashkia Divjakë 279,662 mijë Lekë, fakti 189,216 mijë lekë, realizimi i periudhës është 67 %.

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit të periudhës Janar - Gusht 2023 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 5613/3 prot datë 12.10.2023.

Raportimi i periudhës Janar-Gusht:

Plan Buxheti Bashkia Divjakë 399,125 mijë lekë, fakti 313,799 mijë Lekë dhe realizimi i periudhës 79%.

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit të periudhës Janar - Dhjetor 2023 është dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën nr. 39977 prot datë 26.03.2024.

Raportimi i periudhës Janar-Dhjetor:

Plan Buxheti Bashkia Divjakë 624,698 mijë lekë, fakti 534,110 mijë Lekë dhe realizimi i periudhës 85%.

2.1.4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, celja e fondeve dhe realizimi i tyre.

Bashkia Divjakë në përputhje me VKM, Nr. 285, datë 15.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 3, ka hartuar regjistrimin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik. Në auditimin e kryer në Bashkinë Divjakë referuar regjistrin të parashikimit për procedurat të cilat do të parashikohen të kryhen gjatë vitit 2023 për blerje mallra, shërbime dhe investime janë parashikuar 31 procedura prokurimi me fond limit 233,630,078 lekë duke përfshirë edhe procedurat me blerje nën 100,000 lekë. Referuar regjistrin të realizimit janë zhvilluar 29 procedura prokurimi me vlerë kontrate të lidhur midis autoritetit kontraktor dhe Bashkisë Divjakë në vlerën 204,134,220 lekë. Referuar regjistrin të realizimit, Bashkia Divjakë nuk ka zhvilluar dy procedura prokurimi të cilat janë parashikuar të zhvilloheshin në vitin 2023 referuar VKB Nr.62, datë 23.12.2022 “Për miratimin e buxhetit

Në **aneksin nr. 2/1/11** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqitet lista e procedurave të prokurimit të cilat nuk janë realizuar gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2023 Bashkia Divjakë për investimet kapitale të cilat financohen nga të ardhurat e veta dhe buxhetit janë likuiduar fonde në vlerë 116,333 mijë lekë. Bashkia Divjakë ka parashikuar në plan buxhetin e vitit 2023 likuidime me vlerë 78,528 mijë lekë, realizimi është në vlerën 75,525 mijë lekë. Për investimet të cilat i përkasin periudhës 2019-2022 është planifikuar të likuidohet vlera 58,377 mijë lekë dhe likuidimi faktik është në vlerën 56,768 mijë lekë.

Për investimet e reja gjatë vitit 2023 të planifikuara nga Bashkia Divjakë është planifikuar të likuidohet vlera 20,151 mijë lekë dhe likuidimi faktik është në vlerën 19,058 mijë lekë.

Nga Ministrinë e Linjës për Bashkinë Divjakë janë financuar katër projekte me vlerë kontrate 552,525 mijë lekë. Investimet e financuara nga ministrinë e linjës i përkasin viteve 2021-2022 të cilat janë në proces. Gjatë vitit 2023 është planifikuar të likuidohen fonde me vlerë 28,569 mijë lekë dhe likuidimi me vlerë 28,289 mijë lekë.

Ndërmarrja e Shërbimeve Komunale gjatë vitit 2023 ka kryer investime me vlerë 19,722 mijë lekë dhe likuidime me vlerë 12,702 mijë lekë.

Në **aneksin nr. 2/1/12** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqitet lista e investimeve kapitale të realizuara gjatë vitit 2023 dhe financimi i investimeve në proces.

2.1.5. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, raporti i tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve të FZHR dhe Ministrinë e Linjës.

Bashkia Divjakë në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive me burim financimi të ardhurat e veta dhe granti në vlerën 32,407 mijë lekë. Nga kjo vlerë në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim vlera 32,407 mijë lekë. Gjatë vitit 2023 është likuiduar vlera prej 31,228 mijë lekë për detyrimet e prapambetura dhe ka mbetur për likuidim vlera 1,179 mijë lekë.

Detyrime të reja të krijuara janë në vlerën 34,305 mijë lekë. Totali progresiv i detyrimeve të prapambetura të raportuara nga Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit janë në vlerën 35,484 mijë lekë. Nga këto detyrimet të prapambetura me burim financimi të ardhurat janë në vlerën 7,003 mijë lekë dhe detyrimet të prapambetura nga Buxheti i Shtetit janë në vlerën 28,481 mijë lekë.

Në **aneksin nr. 2/1/13** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqiten detyrimet e prapambetura të raportuara për Bashkinë Divjakë sipas llojit të detyrimit.

Në **aneksin nr. 2/1/14** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqiten faturat e palikujduara të raportuara nga investimet me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë Divjakë.

Në **aneksin nr. 2/1/15** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqiten faturat e palikujduara të raportuara për mallra me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë Divjakë.

Në **aneksin nr. 2/1/16** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqiten faturat e palikujduara të raportuara për shërbime me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë Divjakë.

Në **aneksin nr. 2/1/17** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqiten faturat e palikujduara të raportuara për investime me burim financimi buxhetin e shtetit.

Referuar kontratave të mëposhtme për të cilat nga ana e Bashkisë Divjakë janë pranuar faturat e operatorë ekonomik por nuk janë raportuar si detyrim i prapambetur.

Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë të detyrimeve të prapambetura dhe detyrime e nga kontratat e mëparshme të cilat janë parashikuar të likujdohen gjatë vitit 2024 nga të ardhurat e veta Bashkia Divjakë nuk duhet të marrë angazhime të reja buxhetore, fillimisht duhet të shlyeje detyrimet nga kontrata e mëparshme. Për këtë duhet të rishikohet edhe buxheti i vitit të ardhshëm duke pakësuar disa nga investimet e parashikuara për mos të patur përkeqësim të situatës së detyrimeve të prapambetura.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 55 “Probleme financiare”

Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2023 -31.12.2023, ngarkohet me përgjegjësi kryetari i Bashkisë Divjakë z. J.G në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. XH.B , me detyrë drejtore i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Bashkia Divjakë për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 3,803,429 lekë e cila i përket vendimit nr. 397, datë 05.02.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit. Bashkia Divjakë ka bërë rekurs përpara Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për vendimin nr.397, datë 05.02.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit. Vendimi nr.397, datë 05.02.2018 ka përcaktuar, detyrimin e palës së paditur “Bashkia Divjakë” ti paguaj palës paditëse shumën prej 20,590,500 lekë dhe shumën 3,344,085 lekë si kamatëvonese për detyrimin e papaguar në shumën 20,590,500 lekë. Gjithashtu sipas vendimit nr.397, datë 05.02.2018 për shpenzimet gjyqësore ngarkohet pala e paditur “Bashkia Divjakë” këto shpenzime janë në vlerën 313,905 lekë dhe tarifë përmbartimore në vlerën 1,759,931 lekë. Gjatë vitit 2023 është kryer pagesa në vlerën 3,803,429 lekë, detyrimi për vendimin e mësipërm është shlyer më pagesën në vlerën 3,803,429 lekë.

Vlera totale **3,803,429 lekë** e shpenzuar për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023 nga Bashkia Divjakë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet. Vështirësia Financiare e Bashkisë Divjakë.**

Vlera e raportuar nga Bashkia Divjakë në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 është **7,003,158 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 1458 prot., datë 29.02.2024 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Në Pasqyrën Nr. 10: Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon

Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraftt etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
II	Detyrimet e prapambetura	7,003,158		1.31%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime Gjyqësore			
4864200	Det.Prap. Shërbime	1,001,345		
4864201	D.P.Energji Elektrike			
4864300	Det.Prap. Mirëmbajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	2,350,524		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	3,651,288		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendetëore			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personale			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
III	Totali (I+II)	7,003,158	534,110,036	1.31%

Burime: Bashkia Divjakë

Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 1.31 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Divjakë në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

Referuar kontratave të investimeve aktive në Bashkinë Divjakë rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura është raportuar në përputhje me udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020 “Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”

Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, mbajnë përgjegjësi; *Kryetari i Bashkisë z. J.G në cilësinë e nëpunësit Autorizues, Z. XH.B Drejtor i financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.*

2.2. Burimi i krijimit i të të ardhurave dhe mbledhje e tyre

2.2.1. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave

2.2.2 Mënyra e llogaritja dhe vlerësimi i të ardhurave sipas zërave (taksa/tarifa), në zbatim të paketës fiskale sipas programit të auditimit.

2.2.3 Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

2.2.4. Evidentimi i debitorëve të pa arkëtuara progresivë dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Divjakë për miratimin e paketës fiskale të vitit 2023, me ndryshime;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranimit faturimit dhe specialistët e kontrollit në terren dhe evidencat e korrespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve;
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;
- Pasqyrat financiare për vitin 2023. Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2023;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe zyra e tatim-taksave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore,

Për vitin 2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 62, datë 23/12/2022, “Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë Divjakë për vitin 2023”, ku përfshihet edhe struktura e sektorit të tatim- taksave, e cila përbëhet nga 14 punonjës me përbërje 1 drejtor, 2 përgjegjës dhe 11 specialistë.

Struktura e sektorit të tatim-taksave për vitin 2023 është paraqitur në **aneksin nr. 2/2/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve.

Me VKB nr. 53, datë 25.11.2022, është miratuar Paketa Fiskale për vitin 2023 e cila do të aplikohet në territorin e Bashkisë Divjakë për vitin 2023.

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt rakordimeve me Degën e Thesarit Lushnje parashikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të Bashkisë Divjakë për vitin 2023

paraqitet në **aneksin nr.22/2** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore është në vlerën **230,126,000 lekë** dhe realizimi në vlerën **157,004,063 lekë** ose në masën **68 %** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **73,121,937 lekë**.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

“Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 10,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 14,107,910 lekë ose realizuar në masën 141%. “Taksë trualli” është planifikuar në vlerën 340,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 531,463 lekë ose realizuar në masën 156%. “Tarifa e zënies së hapësirës publike” është planifikuar në vlerën 4,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 5,825,581 lekë ose realizuar në masën 145%. “Të ardhura nga tarifa e shëtitjes me varkë dhe tarifa e kullës së vizitorëve” është planifikuar në vlerën 5,500,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 10,340,000 lekë ose realizuar në masën 188%.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë:

“Tarifë Pastrimi” është planifikuar në vlerën 27,670,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 17,706,168 lekë ose realizuar në masën 63%. “Tarifë ndriçimi” është planifikuar në vlerën 8,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,533,280 lekë ose realizuar në masën 44 %.

“Tarifë e mirëmbajtjes së kanaleve kulluese dhe tarifa e ujitjes në bujqësi” është planifikuar në vlerën 13,100,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 7,552,234 lekë ose realizuar në masën 57%.

“Tarifë dezinfektimi” është planifikuar në vlerën 27,650,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 4,200,800 lekë ose realizuar në masën 70%. “Taksë toke bujqësore ” është planifikuar në vlerën 51,818,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 28,859,671 lekë ose realizuar në masën 55%.

“Taksë ndërtese” është planifikuar në vlerën 22,500,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 7,785,984 lekë ose realizuar në masën 34%. “Taksë ndikimi në infrastrukturë” është planifikuar në vlerën 23,000,000 lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 11,923,773 lekë ose realizuar në masën 49%.

Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Nga DTTV nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga kjo drejtori nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifatat vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Divjakë që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkallimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar deficit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj., në dëm të interesave të publikut. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e

Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32.

Agjentët tatimorë dhe rakordimet me ta:

Bashkia Divjakë ka disa agjentë tatimorë të cilat operojnë për mbledhjen e taksave të ndara për llogari të Bashkisë Divjakë.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga sektori i tatim-taksave për vitin 2023 rezulton si mëposhtë:

Akt-Rakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier janë mbajtur për periudhën Janar-Dhjetor 2023, akt-rakordimet janë të firmosura nga personat përgjegjës nga Bashkia Divjakë dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

DRSHTRR Fier në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji për llogari të Bashkisë Divjakë dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Fier.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë për vitin 2023 paraqiten si më poshtë:

Në **Pasqyrën Nr.1** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura planifikimet dhe arkëtimet nga agjentët tatimorë për vitin 2023.

Nr.	Emërtimi	Plani 2023	Realizimi 2023	% realizimit
1	Tatimi i Thjeshtë i Fitimit (Agjenti DRT Fier)	1.930.000	14,850	1
2	Tatimi mbi të Ardhurat Personale TAP (Agjenti DRT Fier)	10,000,000	14,107,910	141
3	Taksa e regjistrimit të automjeteve (Agjenti DSHTR)	17,300,000	16,670,584	96
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë (Agjenti ASHK)	440,000	106,435	24
Totali		29,670,000	30,899,779	104

Burimi: Bashkia Divjakë

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Divjakë kryhet në programin Excel. Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Divjakë i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2023, Bashkia Divjakë nuk ka pasur akt-marrëveshje me “Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh.a”, taksat dhe tarifavat vendore sipas paketës fiskale abonentët e Bashkisë Divjakë i bëjnë pagesat në bankë në zyrën e Postës Shqiptare ose në arkën e Bashkisë Divjakë.

Situata e lëvizjes së subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitete në territorin e Bashkisë Divjakë bazuar në ndryshimin e xhiros si dhe të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten si më poshtë.
Në **Pasqyrën nr. 2: Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023.**

Nr	Lloji Biznesit	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivitet	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	524	29	38	515
2	Biznesi Madh	96	4	3	97
(1+2)	Gjithsej	620	33	41	612

Burimi: Bashkia Divjakë

Mënyra e llogaritjes dhe vlerësimi i të ardhurave sipas paketës fiskale:

Me VKB nr. 53, datë 25.11.2022, është miratuar Paketa Fiskale për vitin 2023 e cila do të aplikohet në territorin e Bashkisë Divjakë për vitin 2023.

Nga auditimi janë përzgjedhur 14 dosje biznesi madh dhe 38 dosje biznesi vogël për të analizuar përputhshmërinë e tarifimit të abonentëve privat me paketën fiskale Bashkia Divjakë dhe pagesat e kryera.

Nga auditimi rezultoi se për bizneset të cilët tarifohen për tarifën e zënies së hapësirës publike nuk janë mbajtur akt verifikime për vitin 2023 për hapësirën të cilën përdorin këto biznese. Këto biznese janë tarifuar bazuar në akt verifikimin e vitit 2022.

Nga auditimi rezultoi se për bizneset nga inspektorët e tatim-taksave nuk janë mbajtur akt verifikime për tabelat e vendosura nga bizneset për të cilët në bazë të akt verifikimit e mbajtura nga inspektorët e tatim taksave do të përllogaritet taksa e tabelës sipas paketës fiskale të miratuar me VKB nr. 53, datë 25.11.2022.

Paketa fiskale e Bashkisë Divjakë e cila është miratuar me VKB nr.53, datë 25.11.2022 ka përcaktuar taksat dhe tarifavat e abonentëve familjarë të Bashkisë Divjakë. Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë për vitin 2023 ju ka dërguar abonentëve familjarë njoftim vlerësimet për taksën e tokës bujqësore, taksën e truallit dhe taksën e ndërtesës. Abonentët familjarë nuk janë tarifuar për vitin 2023 për tarifavat vendore në kundërshtim me VKB nr.53, datë 25.11.2022 “Paketa fiskale për sistemin e taksave e tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2023” dhe Ligjin Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 7, pika 2.

Menaxhimi i borxhit

Abonentët familjarë debitorë në njësitë administrative dhe në qytetin e Divjakë paraqiten në fund të vitit 2022 për vlerën 447,788,681 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrime nga taksat dhe tarifavat vendore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 30,151,465 lekë. Detyrimi për vitet e mëparshme është në shumën 417,637,216 lekë gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në

vlerën 76,451,363 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 494,088,579 lekë nga taksat dhe tarifat për abonentët familjarë.

Në **aneksin nr.2/2/3** janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve progresive sipas njësive administrative për taksat dhe tarifat vendore të vitit ushtrimor 2022.

Në **aneksin nr.2/2/4** janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve progresive sipas njësive administrative për taksat dhe tarifat vendore të vitit ushtrimor 2023.

Në **Pasqyrën nr. 2:**Janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve sipas taksave dhe tarifat vendore dhe numrit të familjeve debitore të vitit ushtrimor 2023 si vijon:

	Emërtimi	Debia deri 2022	Debitorë 2022progresivë (duke zbritur pagesat e vitit 2023)	Debi 2023	Shuma progresive	Nr i familjeve debitore
1	Taksa e tokës bujqësore	318,703,043	298,043,444	41,842,539	339,885,983	9,799
2	Taksa e ndërtesës	35,739,923	32,771,593	8,170,409	40,942,002	7,595
3	Tarifa e Pastrimit	53,975,123	46,656,400	11,064,500	59,009,400	6,866
4	Tarifa e shërbimit komunitar (ndriçimi+gjelbërimi+desinfektim i+ vërtetim)	14,276,728	16,364,141	5,811,607	22,743,448	8,115
5	Tarifë vaditje+ kullim	23,915,990	22,304,165	9,372,916	31,670,431	9,221
6	Tarifë trualli	1,177,874	1,497,473	189,392	1,296,815	6,525
	Total	447,788,681	417,637,216	76,451,363	494,088,579	

Punoi: Grupi i Auditimi

Abonentët privatë debitorë në njësitë administrative dhe në qytetin e Divjakë paraqiten në fund të vitit 2022 për vlerën 34,114,627 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrime nga taksat dhe tarifat vendore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 2,938,934 lekë. Detyrimi për vitet e mëparshme është në shumën 31,175,693 lekë gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 8,380,247 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 39,555,247 lekë i cili i përket 299 bizneseve.

Pasqyrën nr. 3:Paraqitet informacion për subjektet debitorë biznes

Nr	Njësitë	Lloji i bizneseve	Nr subjekteve	Detyrime datë 31.12.2022	Detyrimet 2022(duke zbritur pagesat 2023)	Detyrimet 2023	Total Detyrimet
1	Divjakë	Biz.i vogël	101	16,473,612	15,246,310	2,742,747	17,989,057
		Biz.i madh	13	2,122,516	1,672,516	2,960,595	4,633,111
2	Grabian	Biz. i vogël	24	2,054,804	1,915,853	164,992	2,080,845
3	Tërbuf	Biz. i vogël	61	4,242,111	3,329,997	1,284,813	4,614,810
4	Remas	Biz. i vogël	60	6,898,323	6,854,443	497,120	7,351,563
5	Gradishtë	Biz. i vogël	40	2,323,261	2,156,574	729,980	2,886,554
	Total		299	34,114,627	31,175,693	8,380,247	39,555,940

Punoi: Grupi i Auditimit

Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë, sipas dokumentacionit për arkëtimin e detyrimeve, ka zbatuar procedurën e njoftimit të subjekteve për arkëtimin e detyrimeve, vendosjen e barrës siguroese në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor, vendosjen e barrës hipotekore në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe bllokimin e llogarive bankare. Sektori Juridik nuk ka ndjekur procedurën ligjore për kthimin e shumave debitorë në titull ekzekutiv në mënyrë që këta debitorë të ndiqen nga shërbimi përmbartimor. Veprime të cilat kanë çuar në debitorë të pa arkëtuar, në vlerën 533,644,519 lekë për taksat dhe tarifat vendore për abonentët familjarë/privatë ky detyrim është i kontabilizuar.

Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat

Tatimore”, të ndryshuar. Udhëzim i përbashkët Nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetin minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. III. Procedura për mbledhjen me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore vendore.

Taksa e tokës bujqësore:

Bashkia Divjakë për vitin 2023 ka parashikuar të arkëtoi të ardhura nga taksa për tokën bujqësore në vlerën 51,818,000 lekë realizimi i kësaj takse për vitin 2023 është në vlerën 28,859,671 lekë.

Sipas të dhënave që disponon Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Bashkinë Divjakë sipërfaqja totale e tokës bujqësore i përket 9,724 familjeve dhe sipërfaqja e ndarë e tokës është 20,460 ha.

Në **aneksin nr.2/5** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit paraqitet informacion mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Divjakë

Në **Pasqyrën nr. 4:** Paraqiten debitorët për taksën e tokën bujqësore

Nr	Njësia	Debia deri 2022	Debia progresive 31.12.2023
1	Divjakë	54,867,194	58,449,593
2	Njësia Administrative Gradishtë	52,473,932	56,396,966
3	Njësia Administrative Tërbuf	116,597,598	124,704,976
4	Njësia Administrative Grabian	52,789,015	57,399,721
5	Njësia Administrative Remas	41,975,304	42,934,727
	Total	318,703,043	339,885,983

Punoi: Grupi i Auditimit

Abonentët familjarë debitorë për taksën bujqësore në njësitë administrative dhe në qytetin e Divjakës paraqiten në fund të vitit 2022 për vlerën 318,703,043 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për taksën bujqësore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 20,659,599 lekë. Detyrimi për vitet e mëparshme është në shumën 298,043,444 lekë, gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 41,842,539 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 339,885,983 lekë i cili i përket 9,799 familjeve.

Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Divjakë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Lushnje janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

Debitorë nga vitet e mëparshme në datë 01.01.2023 për taksën e infrastrukturës janë në vlerën 22,765,991 lekë dhe përbëhet nga 603 debitorë. Gjatë vitit 2023 kanë paguar për taksën e infrastrukturës 211 debitorë me vlerë detyrimi 7,917,645 lekë.

Për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën 6,440,141 lekë për 183 persona, për detyrimet e krijuara gjatë vitit 2023 kanë paguar 113 persona me shumë 3,815,720 lekë. Në datën 31.12.2023 për taksën e ndikimit në infrastrukturë kemi total debitorë 279 persona me vlerë **17,472,767 lekë** shumë e cila është e ardhur e pa arkëtuar për Bashkinë Divjakë.

Në **Pasqyrën nr. 5** paraqiten të dhëna për taksën e infrastrukturës për vitin 2023:

Viti	Numri i objekteve të legalizuara që janë debitorë më 31.12.2022	Vlera e detyrimit më 31.12.2022	Pagesat 2023	Borxhi krijuar 2023	Totali detyrimit	Numri personave që kanë paguar 2023
2017	14	626,332	49,612	-	576,720	2
2018	53	1,280,578	125,914	-	1,154,664	6
2019	58	1,601,870	404,948	-	1,196,922	12
2020	279	10,035,437	4,213,969	-	5,688,333	112

2021	158	7,488,413	2,086,985	-	5,401,428	54
2022	41	1,733,359	1,036,216	-	697,144	25
2023	-	-	-	2,624,421	2,624,421	113
Totali	603	22,765,989	7,917,645	2,552,899	17,472,767	324

Burimi:Bashkia Divjakë

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Divjakë për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Divjakë të jetë drejtuar ASHK Dega Lushnje, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27.

Asetet e dhëna me qira:

Bashkia Divjakë, në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre administron 12 kontrata për dhënien me qira të ndërtesave. Bashkia Divjakë ka 7 kontrata aktive të lidhura përpara vitit 2023 me afat 20 vjeçar dhe për vitin 2023 ka lidhur 5 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Tarifa e përcaktuara në kontratat e lidhura gjatë vitit 2023 janë në përputhje me VKM Nr. 54 datë 05.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”. Gjatë vitit buxhetor 2023 Bashkia Divjakë parashikon të ardhura në vlerën 3,183,224 lekë.

Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave të ndërtesave/objekteve rezulton se nuk ka debitorë nga kontrata e qirasë për vitin 2023.

Për këto kontrata të lidhura si dhe pagesat e bëra për qiranë jepen të dhëna **në aneksin nr.2/6** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e Licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Divjakë dhe në Njësitë Administrative, ushtrojnë aktivitetin 14 subjekte të tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin në këtë fushë paraqiten të dhëna **në aneksin nr.2/7** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatua se situata paraqitet si mëposhtë:

1. Subjekti “**G.**, me NUIS K....T, ushtron aktivitet, tregti me shumicë dhe pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Këmishtaj, Njësia Administrative Gradishte, Bashkia Divjakë. Subjekti është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 18.04.2023-17.04.2024.Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën e licencës në shumën 200,000 lekë në datë 07.07.2023.Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

2. Subjekti “**M.Shpk**, me NUIS K....F, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 21.04.2023-20.04.2024.Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën e licencës në shumën 200,000 lekë në datë 14.09.2023.Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për

përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

3. Subjekti “M.” Shpk, me NUIS K.....L, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë 5 vjeçare nga data 11.02.2020-10.02.2025. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën e licencës në shumën 200,000 lekë në datë 28.09.2021 dhe pagesë në datë 10.10.2023 shuma 200,000. Nga informacioni i mësipërm subjekti “M.” shpk ka detyrim të pa paguar në vlerën 600,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

4. Subjekti “P.” Shpk, me NUIS L.....A, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 15.11.2022-14.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën e licencës në shumën 200,000 lekë në datë 17.07.2023. Pasi ka mbaruar afati i licencës për subjektin “P...” Shpk është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 10.11.2023-09.11.2024 pagesa për licencimin është kryer në datën 11.09.2023 në shumën 200,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

5. Subjekti “V.....Shpk, me NUIS K.....K, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 04.11.2022-03.11.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën e licencës në shumën 200,000 lekë në datë 04.12.2023. Pasi ka mbaruar afati i licencës për subjektin “V.....” Shpk është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 03.11.2023-02.11.2024 pagesa për licencimin është kryer në datën 14.06.2024 në shumën 200,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

6. Subjekti “K.....” Shpk, me NUIS K.....T, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 03.04.2022-02.04.2023. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën e licencës në shumën 200,000 lekë në datë 07.10.2022. Pasi ka mbaruar afati i licencës për subjektin “K. T&L” Shpk është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 02.04.2023-01.04.2024 pagesa për licencimin është kryer në datën 18.06.2023 në shumën 200,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

7. Subjekti “A.” Shpk, me NUIS K.....M, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 5 vjeçar nga data 26.12.2018-25.12.2023. Pasi ka mbaruar afati i licencës për subjektin “A..” Shpk është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 25.12.2023-24.12.2024 pagesa për licencimin është kryer në datën 27.05.2024 në shumën 200,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

8. Subjekti “G, me NUIS1T, ushtron aktivitet, tregti me shumicë dhe pakicë të naftës dhe nënprodukteve të saj me adresë ushtrim aktiviteti Divjakë, pranë shkollës së mesme Bashkia Divjakë. Subjekti është pajisur me licencë 1 vjeçare nga data 18.04.2023-17.04.2024. Nga auditimi rezulton se subjekti ka kryer pagesën e licencës në shumën 200,000 lekë në datë 07.07.2023. Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

9. Subjekti “Gj.Shpk, me NUIS J.....R, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 5 vjeçar nga data 12.12.2018-12.12.2023 pagesa për licencimin është kryer në datën 23.01.2019 në shumën 1,000,000 lekë.

Pasi ka mbaruar afati i licencës për subjektin “Gj.” Shpk është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 12.12.2023-11.12.2024 pagesa për licencimin është kryer në datën 14.12.2023 në shumën 200,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

10. Subjekti “L.” Shpk, me NUIS K.....U, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 5 vjeçar nga data 12.12.2018-12.12.2023 pagesa për licencimin është kryer në datën 04.02.2019 në shumën 1,000,000 lekë.

Pasi ka mbaruar afati i licencës për subjektin “L....” Shpk është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 12.12.2023-11.12.2024 pagesa për licencimin është kryer në datën 17.05.2024 në shumën 200,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

11. Subjekti “K.” Shpk, me NUIS L.....U, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 5 vjeçar nga data 04.12.2018-04.12.2023 pagesa për licencimin është kryer në datën 04.12.2018 në shumën 1,000,000 lekë.

Pasi ka mbaruar afati i licencës për subjektin “**K.**” **Shpk** është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 04.12.2023-03.12.2024 pagesa për licencimin është kryer në datën 22.05.2024 në shumën 200,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

12. Subjekti “A.” Shpk, me NUIS L.....U, ushtron aktivitet tregtim me pakicë lëndë djegëse.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 5 vjeçar nga data 06.01.2021-05.01.2026 pagesa për licencimin është kryer në datën 21.07.2021 në shumën 100,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

13. Subjekti “E.” Shpk, me NUIS K.....T, ushtron aktivitet tregtim me pakicë të hidrokarbureve e nënprodukteve të saj.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 14.08.2022-13.08.2023 pagesa për licencimin është kryer në datën 25.08.2022 në shumën 200,000 lekë.

Pasi ka mbaruar afati i licencës për subjektin “**E.**” **Shpk** është pajisur me licencë me afat 1 vjeçar nga data 13.08.2023-12.08.2024 pagesa për licencimin është kryer në datën 16.08.2023 në shumën 200,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

14. Subjekti “O. Gaz” Shpk, me NUIS L....D, ushtron aktivitet ushtron aktivitet tregtim me pakicë lëndë djegëse.

Subjekti është pajisur me licencë me afat 5 vjeçar nga data 10.10.2022-09.10.2027 pagesa është kryer në shumën 100,000 lekë.

Referuar dokumentacionit të dosjes së subjektit licenca për tregtimin me pakicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj është dhënë në kundërshtim me VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

Nga informacioni dhe dokumentacioni që Bashkia disponon, rezulton që subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve rezultojnë me detyrim 600,000 lekë e cila është e ardhur e pa arkëtuar në buxhetin e Bashkisë Divjakë.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore:

1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar neni 35.

2)VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4.

3)VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 2; germa “a-g”.

Tarifa e Ujitjes:

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Divjakë, rezultoi se për tarifën e ujitjes për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 6,100 mijë lekë, ndërsa realizimi i saj është në vlerën 1,680 mijë lekë, ose 28%. Duke iu referuar VKB-së nr. 53 prot, datë 25.11.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Divjakë” .

Tarifa për shërbimin e ujitjes si mëposhtë:

- 1)Tarifë ujitje me rrjedhje 500 lekë/dy/ujitje
- 2)Tarifë ujitje me ngritje mekanike 200 lekë/dy/ujitje
- 3)Tarifë për ujitje me hidrant Njësia Divjakë 2,000 lekë/dy/vit
- 4)Tarifë ujitje në sera dhe sipërfaqe që përdorin sistemin ujitjes me pika 1,000 lekë/dy/vit.

Struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e saj është Drejtoria e Bujqësisë Mjedisit dhe Ujitjes. Nga auditimi i dokumentacionit i vënë dispozicion pranë grupit të auditimit nga Drejtoria e Bujqësisë Mjedisit dhe Ujitjes rezulton së menaxhimi i kësaj tarife bëhet nga specialistët e ujitjes të cilët rekrutohen me kontratë pune nga Bashkia Divjakë vetëm për sezonin e vaditjes.

Bashkia Divjakë për vitin 2023 gjatë sezonit të vaditjes ka rekrutuar 10 specialistë ujitje të cilët janë të ndarë sipas Njësive Administrative për marrjen e kërkesave nga fermerët për vaditjen dhe tarifimin e fermerëve sipas paketës fiskale të Bashkisë Divjakë.

Specialistët e ujitjes pajisjen me mandat arkëtime nga ekonomisti i drejtorisë me qëllim prerjen e faturave për fermerët në momentin e marrjes së shërbimit

Nga auditimi konstatohet se nga shuma totale e faturuar për vitin 2023 është në vlerën 1,751,650 lekë nga kjo vlerë është arkëtuar shuma 1,638,050 lekë. Shuma debitore është 113,600 lekë e cila i përket 51 fermerëve.

Nga verifikimi i dokumentacionit të audituar, Drejtoria e Bujqësisë Mjedisit dhe Ujitjes nuk administron kërkesat e fermerëve për ujitje (madhësinë e tokës që i nevojitet për ujitjes),por këto kërkesa merren në mënyrë verbale nga specialistët e ujitjes sipas Njësive Administrative.

Gjithashtu edhe kërkesat që bëhen nga specialistët e ujitjes në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Ujitjes për sasinë e kërkuar të ujit për ujitje nuk janë të dokumentuara. Mos dokumentimi i procesit të kërkesave sjell mungesë informacioni për sasinë reale të tokës bujqësore të ujitur në Bashkinë Divjakë.

Spektori i Ujitjes dhe Kullimit ka është vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore si vijon: Ligji nr. 24/2017 “Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit”:- Neni 40: Regjistrat, pika 2. “Çdo bashki/organizatë mban këta regjistra:... ç) regjistër për sasinë e ujit ose numrin e ujitjeve të përfituara nga anëtarët; d) regjistër për pagesat e detyruara, tarifën për t’u paguar dhe ato të paguara; e) regjistër për inspektimet dhe kontrollet e infrastrukturës së ujitjes, si dhe regjistër për inspektimet dhe kontrollet e digës, sipas legjislacionit përkatës”.

Gjobat e IMTV

Për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Divjakë është njoftuar zyra juridike për vazhdimin e procedurave për arkëtimin e gjobave të vendosura. Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Divjakë për periudhën objekt auditimi janë vendosur 18 (tetëmbëdhjetë) gjoba në vlerën 2,327,000 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 677,000 lekë, për 5 (pesë) gjoba të vendosura. Gjoba të vendosura përpara vitit 2023 janë 35 (tridhjetë e pesë) gjoba në vlerën 13,185,000 lekë nga të cilat janë arkëtuar 10 (dhjetë) gjoba në vlerën 685,000 lekë. Gjatë viti 2023 janë referuar në gjykatë 38 (tridhjetë e tetë) raste të ndërtimeve pa leje të konstatuara në vlerën 14,150,000 lekë të cilat i janë referuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Fier për tu shpallur në titull ekzekutiv

Sa më sipër rezulton se për të gjitha praktikat IMT-ja, Drejtoria Juridike ka ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve.

Në **aneksin nr.2/9** në anekset e projekt raportit të auditimit paraqiten të dhënat për gjobat e vendosura nga Sektori i IMTV.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

1. Z. J.G, me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues,
2. Z. R.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave Vendore.
3. Zj. A.H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimi të Procedurave.
4. Z. F.V me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit dhe Vlerësimit.
5. Z. A. S me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes.
6. Zj. Z. M me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit.

Për sa trajtuar në Projekt Raportit e Auditimit dërguar me shkresë 752/4, datë 06.08.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Divjakë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4726/10prot., datë 27.08.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit i dërguar pranë Bashkisë Divjakë me nr.752/4 prot, datë 06.08.2024 Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore paraqet observacionet si mëposhtë për procedurën e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

1-Janë bllokuar llogaritë bankarë të subjekteve debitorë sipas shkresave Nr.305-343 prot, datë 18.01.2023, Nr.3786-3793 prot, datë 11.07.2023, Nr.4724-4733 prot, datë 12.06.2024.

2-Sipas shkresës Nr.3230 prot, datë 18.04.2024 është barrë sigurorese pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor.

3-Sipas shkresës Nr.3229 prot, datë 18.04.2024 është vendosur barrë hipotekore pranë ASHK.

4-Sipas shkresës Nr.3234 prot, datë 18.04.2024 i është dërguar lista emërore të subjekteve debitorë Sektorit juridik dhe prokurimeve publike për vazhdimin e procedurës për ndjekje penale.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Divjakë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 752/4, datë 06.08.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Gjykojmë se Bashkia Divjakë ka sjellë argumente të qenësishme të cilat ndikojnë në konstatimet tona. Për sa më lart komentet merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

2.3.4. Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale sa prej tyre janë me çertifikatë pronësie.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese (janar-dhjetor 2023).

- Ditarët e kontabilitetit për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.
- Listë pagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore e vitit 2023.
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2023.
- Akt-rakordimet e kryera me degën e thesarit Lushnje për periudhën raportuese të vitit 2023.
- Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2023 Bashkia Divjakë ka hartuar pasqyrat e konsoliduara në të cilat përfshihen dy njësi shpenzuese ,aparati i Bashkisë Divjakë dhe Agjencia e Shërbimeve Komunale. Bashkia Divjakë për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Lushnje si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Bashkisë Divjakë për vitin 2023 janë të nënshkuara nga z. J.G Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. Xh.B me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Lushnje në datë 28.03.2023, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

-Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);

- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;

-Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

-Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;

-Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

-Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.

- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentat vërtetues si urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Divjakë për aktivitetin ekonomik-financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 5,228,027,927 lekë dhe për vitin 2023 është 5,161,972,241 lekë.

Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023:

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

Pasqyra e pozicionit financiar të Bashkisë Divjakë në 31.12.2023, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=4,484,789,892 lekë.**

- Aktivet 5,161,972,241 lekë
- Detyrimet 649,999,148 lekë
- Aktivet Neto 4,484,789,892 lekë

Aktivet afatshkurtra:

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **856,400,268 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 129,633,795 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 76,767,325 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 649,999,148 lekë

Fondi i Konsoliduar:

Llogaria 101 “Teprica (Fondi I akumuluar/Deficit i akumuluar)

Në llogarinë 101 është paraqitur në vlerën 4,027,244,298 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF1: Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zërat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Nxjerrje jashtë përdorimit	170,587,665	4,006,572,846	Çelje
Amortizim i vitit	262,731,699	443,234,427	Investime + Dhurime
		10,756,389	Ndryshim i gjendjes së inventarit
	433,319,364	4,460,563,662	
Shuma		4,027,244,298	

Burimi: Bashkia Divjakë

Sipas tabelës së mësipërme e përlllogaritur dhe sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” vlera e raportuar në bilanc kuadron sipas udhëzimeve përkatëse.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 129,633,795 lekë, përbëhet nga gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 102,450,594 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 27,183,201 lekë.

Lëvizjet e klasës 5“Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, paraqitet në **aneksin nr.2/3/1** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 129,633,795 lekë kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje".

Fondet e papërdorura për vitin 2023 janë si më poshtë:

1-Trasfertë e pakushtëzuar dhe specifike viti 2023 e papërdorur 78,067,247 lekë.

2-Të ardhurat viti 2023 të papërdorura 24,383,347 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 102,450,594 lekë fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2023.

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Divjakë në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 76,767,325 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 38,300,042 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 38,467,283 lekë.

Lëvizjet e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, paraqitet në **aneksin nr.2/3/2** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime për të cilat u kërkua dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e mëposhtme disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë hyrje në magazinë

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë dalje nga magazine.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =-10,756,389 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 10,756,389 lekë.

Llogaria 312 “Materiale”, ka vlerën 38,300,042 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	27,403,245
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	141,006,657
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	130,109,860
Gjendja në 31.12.2023	38,300,042

Burimi:Bashkia Divjakë

Llogaria 327 “Objekte inventari”, ka vlerën 38,607,691 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	38,607,691
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	2,202,971
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	2,343,379
Gjendja në 31.12.2023	38,467,283

Burimi:Bashkia Divjakë

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Divjakë ka nxjerrë Urdhurat e inventarizimit ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u

debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Inventarizimi i aktiveve:

Gjatë vitit 2023, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e titullarit të bashkisë është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.195 datë 13.07.2023 për ngritjen e komisionit të inventarizimit, dhe vlerësimit të aktiveve për vitin 2023 të Bashkisë Divjakë me përbërje:

- 1-D.S (Kryetar)
- 2-A. S (Anëtar)
- 3-A. B (Anëtar)
- 4-P. T (Anëtar)
- 5-S.i Gj (Anëtar)

Komisioni i Inventarizimit dhe Vlerësimit me shkresën nr.4291prot, më datë 03.08.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit ku është konstatuar se:

1-Sipas procesverbalit komisioni ka konstatuar **15 aktivet (rrethime,mure të dëmtuara) me vlerë kontabël 14,053,189 lekë**. Këto aktive janë regjistruar në kontabilitet prej periudhës 1960-2005 të cilat janë amortizuar dhe dëmtuar përgjatë viteve. Këto aktive janë paraqitur në **aneksin nr.2/3/3** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

2-Aktive të privatizuara nga persona të tretë fizik ose juridik **janë 8 aktive me vlerë kontabël 13,055,033 lekë**. Këto aktive paraqiten në **aneksin nr.2/3/4** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Me urdhër Nr.353, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni për vlerësimin e gjendjes së mallrave dhe materialeve në fund të vitit 2023 me përbërje:

- 1-G.k (Kryetar)
- 2-Al. H (Anëtar)
- 3-E. Z (Anëtar)

Me urdhër Nr.354, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve për zyrat e Bashkisë Divjakë me përbërje:

- 1-E. M (Kryetar)
- 2-e.m (Anëtar)
- 3-A S (Anëtar)

Me urdhër Nr.355, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve për Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mjedisit me përbërje:

- 1-I N (Kryetar)
- 2-S. Gj (Anëtar)
- 3-K. K (Anëtar)

Me urdhër Nr.356, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve për Sektorin e Rrugëve Rurale, MZSH, Elektriку dhe Sektori i Turizmit me përbërje:

- 1-L. M (Kryetar)
- 2-S. P (Anëtar)
- 3- L. T (Anëtar)

Me urdhër Nr.357, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve për Shkolla e mesme Divjakë, Shkolla 9 vjeçare Divjakë, Mizë, Gërmenj i madh, Pallati i Kulturës, Biblioteka, Qendra Kulturore e Fëmijëve me përbërje:

1-J. L (Kryetar)

2-J. Z (Anëtar)

3-Xh. Çi (Anëtar)

Me urdhër Nr.358, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve për zyrat e Njësisë Administrative Tërbuf me përbërje:

1-R. B (Kryetar)

2-Z. M (Anëtar)

3-O. M (Anëtar)

Me urdhër Nr.359, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve për zyrat e Njësisë Administrative Grabian me përbërje:

1-M. L.(Kryetar)

2-J. M. (Anëtar)

3-E. H (Anëtar)

Me urdhër Nr.360, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve për zyrat e Njësisë Administrative Gradishtë me përbërje:

1-P. T (Kryetar)

2-A. K (Anëtar)

3-D. Q (Anëtar)

Me urdhër Nr.361, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i inventarizimit të aktiveve për zyrat e Njësisë Administrative Remas me përbërje:

1-L.K (Kryetar)

2-R. S (Anëtar)

3-Ç K (Anëtar)

Me urdhër Nr.362, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i vlerësimit të aktiveve të nxjerrë jashtë përdorimit nga komisionet e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Divjakë me përbërje:

1-P. T (Kryetar)

2-I.M (Anëtar)

3-A. B (Anëtar)

4-D. S (Anëtar)

5-S. T. (Anëtar)

Komisioni i ngritur nga Titullari i Bashkisë Divjakë me Nr.362, datë 30.11.2023 për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të Bashkisë Divjakë ka mbajtur procesverbalin me Nr.685 prot, datë 07.02.2024 për vlerësimin e aktiveve për transferimin dhe nxjerrje nga përdorimi, ku është konstatuar se:

1-Komisioni bëri verifikimin faktik të **15 aktiveve me vlerë 14,053,189 lekë e cila përbëhet nga rethime,mure të dëmtuara**.Sipas vlerësimit të komisionit të ngritur me urdhër Nr.195, datë 13.07.2023 për këto objekte u verifikua vendndodhja dhe statusi i tyre dhe rezultoi se objektet e mësipërme janë të dëmtuara.

2-Në bazë të inventarizimit të kryer me urdhër nr.195, datë 13.07.2023 rezulton **8 objekte me vlerë kontabël 13,055,033 lekë** të cilët janë në inventarin e Bashkisë por njëkohësisht dhe të privatizuara prej individëve.

Institucioni A.SH.K Vendore Lushnje konfirmon nëpërmjet përgjigjes me shkresë nr.3822/1 se këto aktive janë privatizuar në bazë të VKM nr.428 datë 09.06.2010 I METE “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transferohet dhe për procedurën e shitjes”.

3-Për aktivet e klasave 214,218 dhe 327 komisioni ka propozuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit aktivet në vlerë totale 5,031,655 lekë si mëposhtë:

Bashkia Qendër 2,926,651 lekë

Njësia Administrative Tërbuf 1,190,653 lekë

Njësia Administrative Remas 489,969 lekë

Njësia Administrative Gradishtë 424,382 lekë

Për aktivet e propozuara për tu nxjerrë jashtë përdorimit nga komisionet e inventarizimit rezulton se aktivet me vlerë **3,583,580 lekë** janë mjete, vegla pune, tavolina, karrige, veshje pune të cilat janë jashtë çdo kushti përdorimi ndërsa aktive me vlerë **1,448,075 lekë** (kompjutera) komisioni i i ka propozuar për shitje.

Pra si konkluzion, komisioni ka vlerësuar:

-Lista e aktiveve të trupëzuara që nuk janë të dëmtuara 15 aktive me vlerë kontabël 14,053,189 lekë.

-Lista e aktiveve të trupëzuara që janë privatizuar janë 8 objekte me vlerë kontabël 13,055,033 lekë.

-Lista e inventarit ekonomik jashtë përdorimit me vlerë 5,031,654 lekë.

Me urdhër Nr.363, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i Asgjesimit/Tjetërsimit të aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit nga komisionet e inventarizimit të Bashkisë Divjakë.

Komisioni i asgjesimit të aktiveve ka mbajtur procesverbalin me Nr.1839 prot, datë 13.03.2024.

Me vendimin Nr.40, datë 12.02.2024 për tjetësimin dhe nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi është miratuar vendimi për aktivet si më poshtë:

1.Të miratoj daljen jashtë përdorimit të aktiveve të trupëzuara me vlerë 14,053,189 lekë e cila përbëhet nga rethime,mure të dëmtuara.

2.Të miratoj heqjen nga kontabiliteti të aktiveve të qëndrueshme të privatizuar me vlerë 13,055,033 lekë.

3. Të miratoj heqjen nga kontabiliteti të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara me vlerën 39,690,907 lekë e cila përfaqëson shpenzime për mirëmbajtje e riparime të objekteve që nuk janë në pronësi të Bashkisë Divjakë por janë të komunitetit Rom.

4.Të miratoj daljen jashtë përdorimit të aktiveve për riciklim në vlerën 1,448,075 lekë.

5.Të miratoj daljen jashtë përdorimit të inventarit ekonomik me vlerë 3,583,580 lekë të cilat janë depozituar si mbetje.

Konstatim:Sa më lartë u konstatua se me urdhër Nr.363, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i Asgjesimit/Tjetërsimit të aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit nga komisionet e inventarizimit të Bashkisë Divjakë.

Komisioni i asgjesimit të aktiveve ka mbajtur procesverbalin me Nr.1839 prot, datë 13.03.2024.

Me vendimin Nr.40, datë 12.02.2024 për tjetësimin dhe nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi është miratuar vendimi për aktivet si më poshtë:

Të miratoj daljen jashtë përdorimit të aktiveve të trupëzuara me vlerë 14,053,189 lekë e cila përbëhet nga rethime,mure të dëmtuara.Drejtoria e Financës nuk ka dërguar në Këshillin Bashkiak 1(një) relacion për aktivet e dëmtuara në vlerën 14,053,189 lekë për miratim por ka çrregjistruar

nga kontabiliteti këto aktive në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ‘Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik’ pika 120.

Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ”&“Të tjera aktive afatshkurtra”:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr.2/3/6** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 527,417,723 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 575,543,426 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2023 ka pasur rritje me vlerë 48,125,703. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 74,455,722 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është paraqitur në vlerën 53,406,144 lekë. Vlera prej 74,455,722 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF2: Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408	46,557,812
Paga personeli llog 42	23,008,465
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	897,213
Sigurime shoqërore llog.435	3,585,834
Sigurime shëndetësore llog.436	406,398
Totali	74,455,722

Burimi:Bashkia Divjakë

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur saktë dhe kuadron me llogaritë e klasës 4.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” e cila është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 21,049,578 lekë në kundërshtim me udhëzimin Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Për sa trajtuar në Projekt Raportit e Auditimit dërguar me shkresë 752/4, datë 06.08.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Divjakë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4726/10prot., datë 27.08.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit i dërguar pranë Bashkisë Divjakë me nr.752/4 prot, datë 06.08.2024 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit paraqet observacionet si mëposhtë

Llogaria 4342 “Te tjera operacione me shtetin”(te drejta)shpreh ne debi te pozicionit financiar vlerën 75 455 722 leke qe përfaqëson paga, shpenzime ne muajin e fundit te periudhës raportuese. Ndërsa llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” e cila pozicionohet ne pasqyrën e performancës financiare te periudhës raportuese. Ne këtë pasqyre shprehen llogarite financiare te te ardhurave te vitit raportues, fondet e trashëguara,, fondet nga transfertat e pakushtëzuara etj. Si

rezultat llogaria 7206 i përket fondeve te trashëguara te periudhës se raportimit ne vlerën 53 406 144 leke ne baze te rakordimit me thesarin.

Mbështetur ne piken 15.b te udhëzimit nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore”

“Llogaria 4342“Te tjera operacione me shtetin”(te drejta) kreditohet për pjesën e fondeve te përdorura gjate vitit ushtrimor, për llogari te shpenzimeve te realizuara vitin e mëparshëm por te financuar me fondet buxhetore te vitit ushtrimor raportues”

Pika 15.c –Ne fund te vitit ushtrimor, për fondet buxhetore te papërdorura gjate vitit ushtrimor behet regjistrimi kontabël debitohet llog. 476 “te ardhura te caktuara për tu përdorur, dhe kreditohet llog. 520 “disponibilitete ne thesar”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Divjakë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 752/4, datë 06.08.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Referuar udhëzimit nr.8, datë 19.03.2018 përcaktohet se:

Llogaritë e Marrëdhënieve me shtetin

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike te tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm.

Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;

Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;

Kreditohet llogaria 7206 ”Financim i pritshëm nga buxheti”.

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi:

Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4);

Kreditohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.

d) Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër:

Debitohet llogaria 476” Të ardhura të caktuara për tu përdorur”;

Kreditohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Aktivitet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivitet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 39,193,173 lekë, amortizim të akumuluar në vlerën 12,268,098 lekë dhe vlerë neto 26,925,075 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” rezulton se projektet e regjistruara në këtë llogari nuk janë vendosur në zbatim. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur blerje projekte të reja.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr.2/3/7** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepricë neto 3,950,476,973 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 3,940,561,910 lekë. Gjatë viti 2023 kemi patur shtesë të AAM-ve blerje me pagesë në shumën 260,549,284 lekë, shtesa pa pagesë janë në shumën 3,456,800 lekë dhe lëvizje brenda aktiveve në vlerën 179,228,343 lekë. Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 262,731,699 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi ose lëvizje ndërmjet llogarive kanë qenë në shumën 170,587,665 lekë. Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF3: Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”.

Nr Llog	Emërtimi	Teprica neto në 31.12.2022	Shtesa 2023	Amortizim 2023	Pakësime 2023	Gjendja me 31.12.2023
210	Toka, Troje, Terrene	144,943,603	2,147,600	6,848,785	130,041,509	10,200,909
211	Pyje, Kullota, Plantacione	2,041,769	-	-	-	2,041,769
212	Ndërtime e Konstruksione	835,498,525	68,682,147	40,188,867	39,962,162	824,029,643
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	2,764,381,191	353,779,146	189,610,181	583,994	2,927,966,162
214	Instalime dhe paisje	49,508,289	10,237,943	10,612,520	-	49,133,712
215	Mjete Transporti	88,038,691	5,046,191	4,676,338	-	88,408,544
218	Inventar Ekonomik	23,530,206	3,341,400	5,100,447	-	21,771,159
	Shuma	3,940,561,910	443,234,427	262,731,699	170,587,665	3,950,476,973

Burimi:Bashkia Divjakë

1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene” është paraqitur në bilanc në datën 31.12.2023 me vlerë kontabël neto 10,200,909 lekë dhe amortizim i vitit 2023 në vlerën 6,848,785 lekë. Amortizimi për këtë llogari është përllogaritur vetëm për aktivet të cilat janë klasifikuar jo saktë në llogarinë 210 “Toka,troje,terrene” dhe duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 212 “Toka, troje, terrene”. Gjatë vitit 2023 llogaria 210 “Toka, troje terrene” ka pasur shtesa në vlerën 2,147,600 lekë dhe pakësime në vlerën 130,041,509 lekë. Kjo llogari është shtuar me vlerën 2,147,600 lekë për aktivin “Shpronësim për varrezat në fshatin Çermë e sipërme” dhe është pakësuar për vlerën neto kontabël 130,041,509 lekë e cila përbëhet nga 3 aktive si më poshtë, nga të cilat janë transferuar në llogarinë 213 “Rrugë,rrjete,troje” vlera 128,501,461 lekë dhe nxjerrja nga perdorimi e aktiveve me vlerë 1,540,048 lekë, cituar më poshtë në këtë material.

1-Terren sportiv Karavasta (rrethime) me vlerë kontabël neto 544,193 lekë.

2-Terren sportiv Remas (rrethime) me vlerë kontabël neto 995,855 lekë.

3- Rivitalizim sheshi qëndror dhe trotuari Divjakë me vlerë kontabël neto 128,501,461 lekë.

Referuar procesit të inventarizimit në Bashkinë Divjakë Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar së në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” janë të kontabilizuara 2 aktive të cilat nga konstatimi në terren i grupit të vlerësimit, këto aktive nuk janë më fizikisht.

1-Terren sportiv Karavasta (rrethime) me vlerë kontabël neto 544,193 lekë.

2-Terren sportiv Remas (rrethime) me vlerë kontabël neto 995,855 lekë.

Referuar relacionit të Komisionit të Vlerësimit me shkresën nr.685/1 prot, datë 07.02.2024, Komisioni i Asgjësimit me vendimin nr.40 datë 12.02.2024 ka vendosur nxjerrjen e aktiveve të mësipërme nga përdorimi.

Aktivi “Rivitalizim sheshi qëndror dhe trotuari Divjakë” me vlerë kontabël neto 128,501,461 lekë është transferuar tek llogaria ekonomike 213 “Rrugë, rrjete, troje” sepse sipas nomenklaturës së llogarive të planit kontabël ky aktiv nuk ka qenë i regjistruar saktë në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”.

Referuar objekteve të regjistruara në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” rezultojnë tre aktive të regjistruara në kundërshtim me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël të cilat i përkasin llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”.

-Rikonstruksion lulishte nr.1 me kosto historike 299,400 lekë

-Rikonstruksion lulishte nr.2 Grabian me kosto historike 398,246 lekë

-Lulishte tregu javor me kosto historike 1,856,026 lekë

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr.2/3/8** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

2. Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 me vlerë 2,041,769 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,041,769 lekë. Kjo vlerë e regjistruar në këtë llogari i përket aktiveve që administrohen nga Agjencia e Ndërmarrjes Komunale e cila është ndërmarrje varësie e Bashkisë Divjakë. Në kundërshtim me SKK Nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale” pika 43 dhe 44 përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajta, Agjencia e Ndërmarrjes Komunale ka regjistruar investimet që ka kryer ndër vite për mbjelljen e pemëve si aktive të llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”. Investime e kryera duhet të kapitalizoheshin në vlerën e aktivit të llogarisë 213 sipas aktivit përkatës sepse kemi përmirësim dhe rritje të vlerës së aktivit dhe jo krijim të ri aktivit i cili mund të regjistrohet në llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”.

3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” cila pasqyron gjendjen e 155 aseteve për llogari të Bashkisë Divjakë, në fund të vitit 2022 rezulton me vlerë kontabël neto 835,498,525 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksione” përbëhet prej 139 aseteve me vlerë kontabël neto 824,029,643 lekë.

Gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” ka pasur shtesa në vlerën 68,682,147 lekë dhe pakësime në vlerën 62,529,775 lekë. Gjatë vitit 2023 nga investime e kryera nga Bashkia Divjakë janë kryer kontabilizimet për katër objekte në llogarinë 212 “Ndërtime dhe Konstruksione”.

-Shkolla e mesme Fier-Seman për vlerën 4,076,544 lekë (shtesë investimi)

-Ndërtim Kopshti me drekë Çermë Sektor për vlerën 2,530,707 lekë (shtesë investimi)

-Rikonstruksion i banesave të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore Bashkia Divjakë për vlerën 5,846,966 lekë (investim i ri).

-Ndërtim palestre dhe rikonstruksioni i shkollës së mesme Çermë Sektor për vlerën 56,227,930 lekë (investim i ri).

Investimi “Rikonstruksion i banesave të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore Bashkia Divjakë për vlerën 5,846,966 lekë (investim i ri)” është kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në kundërshtim me udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore”.

Hyrjet e AAGJ dokumentohen:

1)Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).

2)Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt-marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit.

3)Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim.

4)Për rivlerësimet, si dokument shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve.

Për realizimin dhe krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, ka një procedurë specifike.

-Fillimisht, për njësitë planifikohen dhe realizohen operacionet e investimeve për blerjen apo krijimin e aktiveve afatgjata.

-Për rrjedhim, aktivet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim pra të jenë funksionale ato detyrimisht duhet të gjenden në proces. Në formën e shpenzimeve që grupohen më analiza në llogarinë 23 “Investime”.

-Këto janë investime në proces ,pra aktivi ende nuk është përfunduar dhe detyrimisht nuk është në funksion dhe nuk është kapitalizuar.

-Me përfundimin e ciklit të blerjes apo ndërtimit të aktiveve, këto behën funksionale dhe kapitalizohen në grupet 20 dhe 21 të aktiveve të përfunduara.

Pakësimet:

Gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksione” është pakësuar nga nxjerrja nga përdorimi i 18 objekteve me vlerë historike 62,529,775 lekë dhe vlerë amortizimi 22,567,613 lekë.

Referuar procesit të inventarizimit në Bashkinë Divjakë Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar së në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” janë të kontabilizuara 9 aktive me vlerë 8,555,535 lekë të cilat nga konstatimi në terren i grupit të vlerësimit nuk janë më fizikisht dhe 8 aktive me vlerë 13,055,033 lekë të cilat janë privatizuar në zbatim të VKM nr.428, datë 09.06.2010 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, si më poshtë.

Pasqyra PF4: Aktive të dëmtuara:

Nr	Llog	Emërtimi	Vl. Kontabël	Sasi Kontabël	Sasi fizike	Vlera
1	212	Rrethim Fusha e Sportit Grabian	4,943,833	1	0	4,943,833
2	212	Rrethim varrezave Kryekuq	1,089,663	1	0	1,089,663
3	212	Tregu Divjakë	663,982	1	0	663,982
4	212	Tualete të shkollës Çermë, Shkumbin	199,266	1	0	199,266
5	212	Shkolla Filllore Sopëz	864,534	1	0	864,534
6	212	Tualete shkolla Karavasta e Re	10,000	1	0	10,000
7	212	Ambulanca Remas	204,153	1	0	204,153
8	212	Gabina 118-120	99,376	1	0	99,376
9	212	Njësi shitje vajguri	480,728	1	0	480,728

Totali	8,555,535	9	0	8,555,535
---------------	------------------	----------	----------	------------------

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Pasqyra PF5: Aktive të privatizuara

Nr	Llog	Emërtimi	Vl. Kontabël	Sasi Kontabël	Sasi fizike	Vlera
1	212	Gabina 7-8	238,570	1	1	238,570
2	212	Gabina 9-10	238,570	1	1	238,570
3	212	Gabina 78-85	982,094	1	1	982,094
4	212	Gabina 86-93	944,482	1	1	944,482
5	212	Pallati Nr.2	2,693,382	1	1	2,693,382
6	212	Pallati Nr.3	3,693,382	1	1	3,693,382
7	212	Pallati Nr.4	2,693,382	1	1	2,693,382
8	212	Banjo Publike	1,571,171	1	1	1,571,171
Total			13,055,033	9	9	13,055,033

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar relacionit të Komisionit të Vlerësimit pas verifikimeve me shkresën nr.685/1 prot, datë 07.02.2024, Komisioni i Asgjësimit me vendimin nr.40 datë 12.02.2024 ka vendosur nxjerrjen e aktiveve të mësipërme nga përdorimi.

-Aktive të cilat nuk janë në pronësi të Bashkisë Divjakë

-Rikonstruksion banesa komuniteti Rom dhe Egjiptian me kosto historike 39,690,907 lekë.

Aktivi “Rikonstruksion i banesave të komunitetit Rom dhe Egjiptian” është nxjerr nga llogari 212 sepse këto banesa nuk janë në pronësi të Bashkisë Divjakë por në pronësi të komunitetit Rom.

Aktivi i mësipërm është nxjerr nga llogaria 212 sepse këto janë banesa në pronësi të qytetarëve dhe jo të bashkisë. Kontabilizimi i mësipërm është kryer në mospërputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”

Analiza e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF6: Detajet e nënrubrikës “Ndërtesa Konstruksione”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
1,215,562,171	380,063,646	68,682,147	62,529,775	40,188,867	1,221,714,543

Burimi: Bashkia Divjakë

4. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në fund të vitit 2022 rezulton me vlerë neto kontabël 2,764,381,191 lekë e përbërë ng 181 asete për llogari të Bashkisë Divjakë. Në fund të vitit 2023 kjo llogari paraqitet me 182 asete me vlerë kontabël neto 2,927,966,162 lekë.

Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 174,550,803 lekë dhe pakësime në vlerën 1,181,880 lekë.

Gjatë vitit 2023 nga investime e kryera nga Bashkia Divjakë janë kryer kontabilizimet për nëntë objekte me vlerë 174,550,803 lekë në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nga të cilat 4 investime të reja me vlerë 159,565,717 lekë dhe 5 shtesa investimesh në vlerën 14,985,086 lekë si më poshtë.

-Rruga Dushkcan-Grabian për vlerën 2,969,928 lekë (shtesë investimi)

-Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës Çermë Sektor, Tërbuf për vlerën 1,000,000 lekë (shtesë investimi)

- Blerje çakëll për vlerën 3,321,918 lekë
- Blerje binder për vlerën 26,220,132 lekë (investim i ri)
- Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës Remas për vlerën 2,000,000 lekë (shtesë investimi).
- Rikualifikim i rrugës 20 janari Divjakë për vlerën 5,693,240 lekë (shtesë investimi)
- Furnizim me ujë për zonat bregdetare Remas Bashkia Divjakë për vlerën 123,947,785 lekë (investim i ri).
- Blerje tuba të brinjëzuar për KUB dhe KUZ Bashkia Divjakë për vlerën 5,264,019 lekë (investim i ri)
- Rehabilitim i rezervuarëve dhe përrenjve që ndodhen në territorin e Bashkisë Divjakë për vlerën 4,133,781 lekë (investim i ri).

Pakësimet e llogarisë 213:

Gjatë vitit 2023 llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” është pakësuar nga nxjerrja nga përdorimi i 3 objekteve me vlerë historike 1,181,880 lekë dhe vlerë amortizimi 597,886 lekë.

Referuar procesit të inventarizimit në Bashkinë Divjakë Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar së në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” janë të kontabilizuara 3 aktive me vlerë 1,181,880 lekë të cilat nga konstatimi në terren i grupit të vlerësimit nuk janë më fizikisht.

Pasqyra PF7: Aktive të dëmtuara:

Nr	Llog	Emërtimi	Vl. Kontabël	Sasi Kontabël	Sasi fizike	Vlera
1	213	Lemi Ferras	86,800	1	0	86,800
2	213	Mur rrethues Q shëndetësore Grabian	795,080	1	0	795,080
3	213	Nivelim kanal betoni tek lemi	300,000	1	0	300,000
Total			1,181,880	3	0	1,181,880

Burimi: Përpunoi Grupi i Auditimit

Referuar relacionit të Komisionit të Vlerësimit pas verifikimeve me shkresën nr.685/1 prot, datë 07.02.2024, Komisioni i Asgjësimit me vendimin nr.40 datë 12.02.2024 ka vendosur nxjerrjen e aktiveve të mësipërme nga përdorimi.

Lëvizje të aktiveve:

-Rivitalizim sheshi qëndror dhe trotuari Divjakë për vlerën 179,228,343 lekë, transferim nga llogaria 210 “Toka, Troje dhe Terrene”

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

Pasqyra PF8: Detajet e nënrubrikës “Rrugë, rrjete, vepra ujore”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Shtesa nga transferimet	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
3,583,869,807	819,486,616	174,550,803	179,228,343	583,994	189,610,181	3,936,467,073

Burimi: Bashkia Divjakë

5. Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”. Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Divjakë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Divjakë gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerën kontabël neto 49,133,712 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune” është ulur me vlerën 374,577 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 10,237,943 lekë. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 10,612,520 lekë. Pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimit është në vlerën 842,798 lekë, këto aktive janë të amortizuara dhe paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerë kontabël neto 0 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF9** më poshtë.

Pasqyra PF9: Detajet e nënrubrikës “*Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
89,053,760	39,912,861	10,237,943	-	10,612,520	63,593,138

Burimi: Bashkia Divjakë

6. Llogaria 215 “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Divjakë më datë 31.12.2023 me vlerë neto kontabël 88,408,544 lekë e cila përbëhet prej 32 mjeteve.

Kjo llogari gjatë vitit 2023 është shtuar në vlerën 5,046,191 për blerjen e tre mjeteve. Në vitin 2022 janë blerë dy mjete teknologjike për Agjencinë e Shërbimeve Komunale në vlerën 9,334,800 lekë, kjo vlerë për blerjen e mjeteve është likuiduar në vitin 2022 vlera 6,088,609 lekë dhe në vitin 2023 vlera 3,246,191 lekë gjithashtu në vitin 2023 është blerë kamionçinë vetëshkarkuese me vlerë 1,800,000 lekë. Llogaria është pakësuar nga amortizimi vjetor në vlerën 4,676,338 lekë .

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF10** më poshtë.

Pasqyra PF10: Detajet e nënrubrikës “*Mjete Transporti*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
143,445,279	55,406,588	5,046,191	-	4,676,338	88,408,544

Burimi: Bashkia Divjakë

7. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Divjakë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Divjakë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerën kontabël neto 23,530,206 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 218 “Inventar ekonomik” është ulur me vlerën 1,759,047 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 3,341,400 lekë. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 5,100,447 lekë. Pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimit janë në vlerën 3,191,329 leke, këto aktive janë të amortizuara dhe paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerë kontabël neto 0 leke.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF11** më poshtë.

Pasqyra PF11: Detajet e nënrubrikës “*Inventar Ekonomik*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
63,443,067	39,912,861	3,341,400	-	5,100,447	63,593,138

Burimi: Bashkia Divjakë

Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Divjakë në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (1,571,278,869) lekë që ka të bëjë me amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2023. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (183,257,765) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2023.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr.2/3/9** në anekset e projekt raportit të auditimit.

të auditimit.

Testi substancial i amortizimit

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për

disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Divjakë, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Aktivët Afatgjata Financiare

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2023 në vlerën 355,095,000 lekë. Kjo vlerë e regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar i përket kuotave të Bashkisë Divjakë në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” sh.a Divjakë me NUIS K63731401A ku Bashkia Divjakë ka 100% të kuotave.

-Bashkia Divjakë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 11.21% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale U” sh.a me NUIS M...K e cila është shoqëri aksionare me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”.

Numri i aksioneve është 11,210 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 1,112,000 lekë.

Vlera e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit nuk paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2023, sepse Shoqëria U. SHA, Lushnje nuk ka përfunduar akoma procedurën e bashkimit.

Për sa trajtuar në Projekt Raportit e Auditimit dërguar me shkresë 752/4, datë 06.08.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Divjakë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4726/12prot., datë 04.09.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit i dërguar pranë Bashkisë Divjakë me nr.752/4 prot, datë 06.08.2024 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit paraqet observacionet si mëposhtë.

Aktivët afatgjata financiare rezultojnë në fund të vitit 2023 me vlerë 355,095,000 lekë sqarojmë se shoqëria Ujësjellës Kanalizime Divjakë me nipt. K63731401A, vazhdon procedurën e bashkimit (përthithjes) nga Shoqëria U.SHA, -Lushnje (Shoqëri Aksionare) e themeluar me datë 03.10.2022. Bashkia Divjakë është aksionare me 11.21% të aksioneve me vlerë kontabël 1,112,000 lekë.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka vazhduar te barte në pasqyrat financiare të vitit 2023 vlerën 355,095,000 lekë (aktive financiare) meqenëse procedura e bashkimit (përthithjes) nuk ka përfunduar akoma me U.sha Lushnje.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Divjakë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 752/4, datë 06.08.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Gjykojmë se Bashkia Divjakë ka sjellë argumente të qenësishme të cilat ndikojnë në konstatimet tona.

Investimet:

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 0 lekë.

Referuar projekteve të investimeve nga Bashkia Divjakë përgjatë viteve 2019-2023 rezulton se projekti “Rikonstruksion i banesave të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore Bashkia Divjakë për vlerën 5,846,966 lekë (investim i ri)” nuk është i përfunduar ky investim nuk është kolauduar dhe si i tillë nuk mund të kontabilizohet në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” por deri në momentin e kolaudimit dhe marrjes në dorëzim duhet të jetë i pasqyruar në llogarinë 231 “Investime për Aktive Afatgjata Materiale”. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin Nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.8, datë 09.03.2018”

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Divjakë më datë 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Pasqyra PF12: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.

Llogaritë		Viti 2023	Viti 2022	Diferenca
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	46,557,812	89,294,330	(42,736,518)
42	Detyrime ndaj personelit	23,008,465	19,396,117	3,612,348
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	897,213	716,846	180,367
435	Sigurime shoqërore	3,585,834	3,012,079	573,755
436	Sigurime shëndetësore	406,398	341,367	65,031
467	Kreditor të ndryshëm	0	0	

Burimi: Bashkia Divjakë

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2023 është paraqitur në vlerën 46,557,812 lekë dhe paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Divjakë më datë 31.12.2023.

Fatura tatimore të cilat i përkasin muajt nëntor dhe dhjetor 2023 për të cilat nuk ka kaluar afati 60 ditore për tu klasifikuar si detyrimet të prapambetura janë në vlerën 9,619,006 lekë.

Fatura të palikujduara për të cilat ka kaluar afatin 60 ditore janë në vlerën 35,484,491 lekë dhe përbëhen nga 36 fatura tatimore.

Në **aneksin nr.3/10** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit janë paraqitur faturat e palikujduara të cilat janë klasifikuar si detyrime të prapambetura.

Në **aneksin nr.3/11** në anekset e raportit përfundimtar të auditimit janë paraqitur faturat e palikujduara të muajt nëntor dhe dhjetor 2023.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është paraqitur e nënvlerësuar në bilanc për vlerën 389,620,451 lekë për detyrimet e projekteve të investimit për të cilët janë pranuar faturat tatimore.

1. Blerje transformatori dhe paisje mbrojtëse për kabinën elektrike për godinën e Bashkisë. Operatori ekonomik ka lëshuar faturat nr.260, datë 11.04.2023 me vlerë 3,724,152 lekë dhe faturën nr.303, datë 27.04.2023 me vlerë 2,034,312 lekë.. Referuar faturave tatimore vlera prej 958,464 lekë nuk është regjistruar si detyrim në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”.

2.Blerje binderi dhe asfaltim i rrugëve urbane për vitin 2023.Gjatë vitit 2023 nga operatori ekonomik janë lëshuar faturat tatimore me vlerë 48,301,051 lekë. Bashkia Divjakë nga faturat e pranuar ka likuiduar shumën 14,408,064 lekë. Në datën 31.12.2023 rezultojnë faturat të papaguara me nr.338-532 me vlerë totale 35,316,864 lekë. Vlera e faturave 35,316,864 lekë nuk është regjistruar si detyrim në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”.

3.Blerje çakëll makineri për rrugët urbane viti 2023.Gjatë vitit 2023 nga operatori ekonomik janë lëshuar faturat tatimore me vlerë 7,615,700 lekë në muajin maj 2023 nga ana e Bashkisë Divjakë është likuiduar vetëm fatura nr.2451, datë 02.05.2023 me vlerë 1,999,998 lekë. Vlera prej 5,615,702 lekë nuk është pasqyruar si detyrim në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”.

4.Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësitë Administrative Remas Loti I. Bashkia Divjakë ka lidhur kontratën me Nr.360/12 prot, datë 02.04.2021 me operatorin ekonomik “Alba Konstruksion” shpk me vlerë kontratë 496,126,333 lekë. Vlera e likuiduar e kontratës deri në datë 31.12.2023 është në vlerën 122,920,107 lekë kjo vlerë i përket faturave të lëshuar për vitin 2021-2022.

Gjatë vitit 2023 nga operatori ekonomik janë lëshuar fatura tatimore si mëposhtë:

- Faturë Tatimore nr. 94, datë 28.02.2023 me vlerë 64,999,088 lekë;
- Faturë Tatimore nr. 135, datë 31.03.2023 me vlerë 47,624,464 lekë;
- Faturë Tatimore nr. 170, datë 28.04.2023 me vlerë 60,742,116 lekë;
- Faturë Tatimore nr. 214, datë 31.05.2023 me vlerë 39,099,288 lekë;
- Faturë Tatimore nr. 232, datë 27.06.2023 me vlerë 136,530,686 lekë;
- Faturë Tatimore nr. 276, datë 21.07.2023 me vlerë 24,709,236 lekë;

Vlera totale e faturave të lëshuara nga operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk në vitin 2023 është 373,704,878 lekë nga kjo vlerë në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është regjistruar vetëm vlera pjesore e faturës 94, datë 28.02.2023 në vlerën 25,975,457 lekë.

Llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është paraqitur e nënvlerësuar për shumën 389,620,451 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Për sa trajtuar në Projekt Raportit e Auditimit dërguar me shkresë 752/4, datë 06.08.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Divjakë është paraqitur observacioni me shkresën nr. 4726/12prot., datë 04.09.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Prendimi i subjektit:

Në lidhje me projekt raportin e auditimit i dërguar pranë Bashkisë Divjakë me nr.752/4 prot, datë 06.08.2024 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit paraqet observacionet si mëposhtë.

Për vitin 2023 janë dy kontrata punimesh te cilat kanë veçori nga kontratat e tjera si: “Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë, Njësia Administrative Remas” me nr. Kontrate 360/12 date 02.04.2021, “Ndërtim kopshti me dreke në fshatin Çermë Sektor, Njësia Administrative Tërbuf” me nr. Kontrate 3086 datë 20.08.2021.

Fondet e këtyre kontratave janë akorduar prej Ministrive te linjës pra grupi 06 dhe grupi 11.Kontrata e ujesjellësit është e financuar 100% nga ministria e linjës dhe kontrata e kopshtit është financuar 35,000,000 nga Ministra e Arsimit dhe 13,747,877 lekë nga Granti i Bashkisë Divjakë.

Bashkia Divjakë ka financuar fondin i cili është parashikuar në kontratë për objektin “Ndërtim kopshti me dreke në fshatin Cermë Sektor, Njësia Administrative Tërbuf ”. Si rrjedhojë pjesa e

mbetur e likuiditetit financiar u përket ministrive të linjës sipas kontratave si rezultat nuk mund të jenë detyrime të prapambetura dhe nuk janë fonde të cilat duhet të rigjenerohen nga Buxheti i Bashkisë Divjakë ndaj dhe nuk janë paraqitur në shpenzime të periudhave të ardhshme.

Për kontratën me objekt “Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë, Njësia Administrative Remas”, financimi është 100% i Min.Linjës si i tillë nuk mund të jetë pjese e përballueshme nga të ardhurat e pritshme të buxhetit të Bashkisë Divjakë.

Për kontratat me objekt: “Blerje transformatori dhe paisje mbrojtëse për kabinën elektrike për godinën e Bashkisë”, “Blerje binderi dhe asfaltim i rrugëve urbane për vitin 2023”, “Blerje çakëll makineri për rrugët urbane viti 2023”, të cilat janë kontrata të lidhura nga Bashkia Divjakë por që janë të shtrira për likuiditet financiar në vitet 2023,2024 këto të parashikuara dhe në PBA si dhe të pranuar dhe nga operatorët ekonomike. Pavarësisht se objekti është përfunduar likuiditeti financiar është parashikuar në afate dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet detyrim i prapambetur. Në mbyllje të pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor bëhen dhe rakordimet me sistemin e thesarit në lidhje me të ardhurat, shpenzimet, detyrimet financiare sipas pikës 37 të Udhëzimit nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitet e Qeverisjes së përgjithshme”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Divjakë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 752/4, datë 06.08.2024 grupi i auditimit gjykon se:

Referuar udhëzimit nr.8, datë 19.03.2018 përcaktohet se:

Për blerjen, krijimin apo shtesat në aktivet afatgjata jomateriale, trajtimet kontabël lidhur me funksionimin janë si më poshtë.

b) Për konstatimin e shpenzimeve për blerjen apo krijimin e aktivitet:

- Debitohet 230 “Investime” (në proces),
- Kreditohet 404 “Furnitorë për investime”

Referuar udhëzimit të mësipërm për investimet në proces në momentin që konstatohen këto shpenzime duhet regjistruar detyrimi i mësipërm edhe pse në kontratat e lidhura me operatorët ekonomikë është përcaktuar se likuidimi do të kryhet në disa periudha buxhetore. Në pikën e trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit është konstatuar mos regjistrimi i detyrimeve të konstatuara në llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura”

Për sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Divjakë, paraqitet në vlerën 23,008,465 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar në muajin janar 2024 në vlerën 23,008,465 lekë.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 897,213 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor është paguar në janar 2024 në vlerën 897,213 lekë.

Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 3,585,834 lekë dhe 406,398 lekë.

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Divjakë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 27,183,201 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Lushnje.

Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, konstatohet se në këtë llogari vazhdojnë të jenë të ngurtësuara fonde në vlerën 5,175,262 lekë për të cilat ka kaluar afati i garancisë. Në **aneksin nr.2/3/12** në anekset e projekt raportit të auditimit gjenden garancitë e ngurtësuara në llogarinë 466” Kreditorë për mjete në ruajtje” të cilat duhet të çregjistrohen nga kjo llogari.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kap. III, pikat 30, 50, dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pasqyra e Performancës Financiare:

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në **aneksin nr.2/3/13** anekset e projekt raportit të auditimit.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 785,964,704 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Lushnje paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 77,195,645 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 15,000 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 36,775,464 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 40,317,093 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 49,029,710 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 3,926,275 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 45,103,435 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 *“Financim i pritshëm nga buxheti”* në vlerën prej 53,406,144 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 *“Operacione me shtetin (të drejta)”* e cila paraqitet në vlerën 74,455,722 lekë.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 683,514,110 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 *“Paga, shpërblime e të tjera personeli”* për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 284,985,178 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 284,985,178 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë 601 *“Kontribute për sigurime”* për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 46,528,808 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 46,528,808 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë 602 *“Blerje mallra e shërbime”* paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 129,144,456 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 129,144,456 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 *“Transferime për Buxhetet familjare e Individë”* paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 233,291,807 lekë, dhe sipas aktrakordimit me thesarin.

Për vitin 2023 totali i te ardhurave në vlerë është 785,964,704 lekë dhe totali shpenzimeve është 683,514,110 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 102,450,594 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 *“Rezultatit e ushtrimit”*.

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj. për Bashkinë Divjakë).

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2023 numri i punonjësve është miratuar me VKB Nr.62 datë 23.12.2022. Miratuar në total numri 491 punonjës në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 465 punonjës, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Divjakë, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2023 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. Xh B dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë. Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore znj. A S.

Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2023.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2023) dhe konstatohet se ato plotësohen sipas rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Divjakë, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Divjakë, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2023)konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës z. Xh B dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës z. Xh B dhe nga Kryetari Bashkisë z. J G

Tabela e burimit të Financimit të pagave paraqitet në **Pasqyrën PF13** më poshtë:

000/lekë

Periodha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transfertë specifike
Viti 2023	319,926	284,674	88	195,890	81,119	4,247	3,420

Burimi: Bashkia Divjakë

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë paraqitet në **Pasqyrën PF14** më poshtë:

000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2023		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	319,926	284,674	88
2	F. Sig. Shoq	51,335	46,883	91

Burimi: Bashkia Divjakë

Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.

Nga auditimi i dokumentacionit të veprimeve nëpërmjet arkës rezultoi se:

Me arkë janë kryer transaksione financiare, si arkëtim të ardhurash për detyrime nga taksa e tokës bujqësore, taksat e tarifave familjare, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuar me të gjitha ekstremitetet, sipas faturës për arkëtim të lëshuar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, arkëtim gjyko të policisë Bashkiake. Nga arka nuk është kryer asnjë transaksion pagese. Për veprimet me arkë është mbajtur libri i arkës, i cili është mbyllur për çdo muaj dhe është nënshkruar nga personi përgjegjës për arkëtim dhe specialiste të financës e ngarkuar për mbajtjen e ditarit të arkës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pika 64 shprehet 64. *Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë. Përjashtim bëjnë vetëm arkëtimet e tarifave për shërbimin shëndetësor ofruar pacientëve nga njësitë shpenzuese të shërbimit shëndetësor.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

1. Z. J.G, me detyrë ,Kryetar i Bashkisë Divjakë
- 2.Z. XH B Drejtor i Financës në cilësinë e nënpunësit zbatues
- 3.Z. P. T Shef i sektorit të Financës dhe Inventareve.

2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM.

4.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

4.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Listat e inventarëve sipas VKM- ve përkatëse;

-Gjendjen e inventarit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e tyre në Drejtorinë Vendore të DVASHK-së Lushnje;

-Listat e inventarit të pa regjistruar pranë kadastrës Lushnje

Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Bashkia Divjakë me VKB nr. 62, datë 23.12.2022, ka miratuar numrin e përgjithshëm punonjësve dhe strukturën organizative sipas drejtorive/sectorëve për vitin 2023. Struktura e cila merret me administrimin e pasurive është pjesë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Specialistët e Aseteve kanë përgjegjësi për dokumentimin dhe azhurnimin e të dhënave për asetet e Bashkisë Divjakë, mbikëqyrin gjithë procesin e inventarizimit në bazë të urdhrit të titullarit dhe arshivojnë gjithë inventarët, sigurojnë dokumentimin, inventarizimin dhe ruajtjen e mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit përkatës financiar kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të inventarit kontabël të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese, përpilojnë fletët e inventarit të aktiveve të qëndrueshme sipas zyrave në Bashki, institucioneve të arsimit, çerdheve, gjendjes civile, ndriçimit rrugor dhe mbajnë kartelat për aktivet e qëndrueshme dhe inventarin e imët.

Bashkia Divjakë ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Divjakë i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Divjakë. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Divjakë duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrimit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj.,.

Mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të asetëve në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Divjakë dhe Njësi Administrative Tërbuf, Gradishtë, Remas, Grabian në tabelën e mëposhtme paraqitet informacioni mbi gjendjen e pronave në disponim të Bashkisë Divjakë.

Tabela përmbledhëse e pronave Bashkia Divjakë

Nr.	Nj.A	VKM		Në pronësi Në numër	Në përdorim Në numër	Çertifikuar	Inventarizuar	Vlerësuar	Kontabilizuar
		Numër	Datë						
1	Bashkia Divjakë	449	19.07.2006	452	271	24	317	317	317
2		49	31.01.2018	-	21	-			
3		316	02.06.2021	22	-	-			
4	NJA Tërbuf	280	06.04.2011	775	151	4			
5	NJA Gradishtë	948	02.09.2009	274	16	8			
4	Remas	431	04.07.2012	4	-	-			
5	NJA Remas	575	28.05.2009	311	2	25			
6	NJA Grabian	727	01.07.2009	187	10	-			
	TOTAL			2,025	471	61	317	317	317

Burimi: Bashkia Divjakë

Gjatë vitit 2023 është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për të cilën janë vlerësuar vetëm aktive të cilat janë kontabilizuar në pasqyrat financiare për aktivet të cilat janë transferuar në Bashkinë Divjakë dhe Njësitë Administrative nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të këtyre pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Divjakë. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Divjakë, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve dhe më pas regjistrimin në kadastër.

b. Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se nga Bashkia Divjakë disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel, jo sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, konkretisht në të nuk evidentohet datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Gjithashtu nuk është përmbushur detyrimi ligjor për krijimin e një regjistri fizik në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30 si dhe pronat e transferuara me VKM-të për llogaritë 210,211,212 dhe 213 nuk janë të evidentuara në regjistrat të cilat Bashkia Divjakë i mban në programin Excel.

Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Divjakë dhe Njësitë Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

c. Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total 2,496 pasuri si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat 2,025 pasuri në pronësi dhe 471 pasuri në përdorim si më poshtë:

➤ **Bashkia Divjakë**

Me VKM-në nr.449, datë 19.07.2006 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Divjakë, ë”, është miratuar lista inventarit me në total 723 pasuri nga të cilat 452 pasuri në pronësi dhe 271 pasuri në përdorim.

Me VKM-në nr.49, datë 31.01.2018 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Divjakë,” është miratuar lista inventarit me në total 21 pasuri të cilat do të jenë në përdorim.

Me VKM-në nr.316, datë 02.06.2021 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Divjakë, ë”, është miratuar lista inventarit me në total 22 pasuri të cilat do të jenë në pronësi

➤ **Ish-Komuna Tërbuf - sot Njësia Administrative Tërbuf- Bashkia Divjakë**

Me VKM nr.280 datë 06.04.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish-komunës Tërbuf” i është miratuar lista inventarit me në total 926 pasuri nga të cilat 775 pasuri në pronësi dhe 151 pasuri në përdorim.

➤ **Ish-Komuna Gradishtë - sot Njësia Administrative Gradishtë - Bashkia Divjakë**

Me VKM nr.948 datë 02.09.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, në ish-komunën Gradishtë” i është miratuar lista inventarit me në total 290 pasuri nga të cilat 274 pasuri në pronësi dhe 16 pasuri në përdorim. .

Me VKM nr. 431 datë 04.07.2012 “Për transferimin në pronësi të Bashkisë Divjakë të Njesisë Administrative Gradishtë të disa pronave” i janë transferuar 4 (katër) pasuri.

➤ **Ish-Komuna Remas - sot Njësia Administrative Remas - Bashkia Divjakë**

Me VKM nr.575 datë 28.05.2009 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish-komunës Remas” i është miratuar lista inventarit me në total 313 pasuri nga të cilat 311 pasuri në pronësi dhe 2 pasuri në përdorim.

➤ **Ish-Komuna Grabian - sot Njësia Administrative Grabian - Bashkia Divjakë**

Me VKM nr.575 datë 28.05.2009 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të ish-komunës Remas” i është miratuar lista inventarit me në total 197 pasuri nga të cilat 187 pasuri në pronësi dhe 10 pasuri në përdorim.

Inventarët e pronave të paluajtshme të miratuara me VKM përgjatë viteve, dhe VKM për njësitë e tjera administrative nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Divjakë nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Lushnje, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm që kanë pësuar këto pasuri, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30 konstatohet se nga strukturat përgjegjëse nuk janë ngritur grupet e punës apo ndërmarrë masa konkrete për ndjekjen e procedurës së inventarit të pasurive të paluajtshme sipas VKM respektive.

Konstatohet se, edhe në vitin 2023 nuk është marrë ndonjë masë apo procedurë ose ngritur një grup pune që do të ndjekë zbatimin e këtyre VKM si edhe regjistrimin e pronave në ASHK.

Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total 2,496 pasuri si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat 2,025 pasuri në pronësi dhe 471 pasuri në përdorim.

Në total në pronësi të Bashkisë Divjakë janë 2,025 pasuri, nga të cilat 61 pasuri janë të pajisura me certifikatë dhe 1,964 pasuri nuk janë të pajisura me titull pronësie. Gjatë vitin 2023, janë regjistruar 3 prona.

Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Divjakë nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2. germa a, b, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30,

Bazuar VKM-në 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive”, këto janë sipërfaqet pyjore dhe kullosore në pronësi të Bashkisë Divjakë:

- Sipërfaqe totale: **821,84 ha**
- Pyje: **613,3 ha**
- Kullota: **0 ha**
- Toka joproduktive **208,54 ha jo**
- Sipërfaqe shkëmbore: **0 ha**

Në aneksin 2/4/1 në anekset e projekt raportit të auditimi paraqitet tabela me listën e pronave të regjistruara sipas objekteve dhe certifikatës së pronësisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:

Z. J. G, me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues,
Z. D. S, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore me të ardhurat e veta të Bashkisë Divjakë së bashku me transfertat e pa kushtëzuara dhe specifike, për vitin 2023 kanë diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit fillestar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken ka vlerën 634,502 mijë lekë, buxheti i rishikuar ka vlerën 716,523 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 534,110 mijë lekë ose në masën 74%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 362,218 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 323,132 mijë lekë ose në masën 89%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 217,758 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 70,573 mijë lekë ose në masën 32%.

Zëri shpenzime kapitale është planifikuar në vlerën 122,906 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 88,044 mijë lekë ose në masën 71 %.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, planifikuar në vlerën 122,906 mijë lekë dhe realizuar 88,044 mijë lekë ose në masën 71%.

Mosrealizimi i angazhimeve buxhetore ndikohet nga realizimi i të ardhurave nga taksa dhe tarifa vendore, për të cilat nuk janë kryer analiza dhe planifikime realiste. Planifikimi i të ardhurave duhet të korrigjohet gjatë vitit duke u përshtatur me angazhime buxhetore të miratuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, , UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, Udhëzimit MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 , faqe 15-27, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me drejtorinë e tjera të Bashkisë Divjakë, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të

parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, u konstatua se nuk janë realizuar fazat e përgatitjes si më poshtë:

1. Nuk është hartuar raporti i vlerësimit dhe parashikimit afatmesëm të të ardhurave i cili miratohet nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 01.03.2022.

2. Tavanet përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve;

3. Nga drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programeve (EMP) nuk janë paraqitur kërkesat buxhetore dhe kërkesat buxhetore shtesë sipas programit të Kordinatori i GMS, brenda muajit prill 2022. Pjesë e kërkesave buxhetore duhet të jenë edhe objektiva për arritjen e barazisë gjinore, si dhe për njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në komunitetin e tyre pakica rome dhe egjiptiane objektiva për integrimin e tyre në komunitet.

4. Nga Bashkia Divjakë nuk janë organizuar takime konsultative me përfaqësues të komunitetit lokal gjatë fazës së përgatitjes së projekt dokumentit të PBA-së.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2022 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1 , faqe 15-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Divjakë , të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Divjakë dhe të organizojë takime me përfaqësues të komunitetit për hartimin e PBA-së.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se totali progresiv i detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2023 është në vlerën 35,484 mijë lekë. Nga këto detyrimet të prapambetura me burim financimi të ardhurat janë në vlerën 7,003 mijë lekë dhe detyrimet të prapambetura nga Buxheti i Shtetit janë në vlerën 28,481 mijë lekë. Bashkia Divjakë nuk ka prioritarizuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe ka marrë angazhime të reja buxhetore pavarësisht se detyrimet janë në vlerën 35,484 mijë lekë dhe gjatë vitit janë shtuar me vlerën 34,305 mijë lekë. Bashkia Divjakë ka marrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion duke krijuar detyrimeve të prapambetura në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtorja e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet

e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore është në vlerën **230,126 mijë lekë** dhe realizimi në vlerën **157,004 mijë lekë** ose në masën **68%** me një diferencë mosrealizimi ndërmjet planifikimit dhe realizimit në vlerën **73,122 mijë lekë**.

Referuar vlerës **73,122 mijë lekë** të mosrealizimit disa prej zërave fiskal të cilët nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave si më poshtë

1-“Taksë ndikimi në infrastrukturë” është planifikuar në vlerën 23,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 11,923 mijë lekë ose realizuar në masën 49%.,

2- “Taksë ndërtese” është planifikuar në vlerën 22,500 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 7,785 mijë lekë ose realizuar në masën 34%.

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskal si më poshtë:

1-“Taksa mbi të ardhurat personale 2%” është planifikuar në vlerën 10,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 14,107 mijë lekë ose realizuar në masën 141

2-“Të ardhura nga tarifa e shëtitjes me varkë dhe tarifa e kullës së vizitorëve” është planifikuar në vlerën 5,500 mijë lekë ndërsa arkëtimet në vlerën 10,340 mijë lekë ose realizuar në masën 188%.

Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkallim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që:

-Gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshme bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

-Për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit, administrimi i taksave dhe tarifave vendore për abonentët privatë, në Bashkinë Divjakë kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim-Taksave kryhen regjistrim manual të të dhënave (*nuk disponon regjistra fizik*). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Divjakë i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të

formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Tatim Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Tatim Taksave. Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë, të marrë masa për hartimin e regjistrimit të tatimpaguesve fizik/juridik/shtetërorë dhe abonentëve familjarë më të gjitha detyrime vjetore që ato kanë në zbatimin të paketës fiskale të miratuar çdo vit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se arkëtimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifa vendore nuk kryhet nga Agjent Tatimor por nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore. Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë për vitin 2023 në kundërshtim të paketës fiskale të miratuar me VKB nr.53, datë 25.11.2022 “Paketa fiskale për sistemin e taksave e tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2023 nuk ka tarifuar abonentët familjarë për tarifave vendore. Veprime në kundërshtim Ligji Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 7, pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë të marrë masa për të tarifuar abonentët familjarë sipas afateve të përcaktuar në paketën fiskale.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Divjakë më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 28,558,958 lekë ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 27,183,201 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Për 28 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Divjakë janë ngurtësuar fonde në vlerën 5,175,262 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Lushnje, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimi të Territorit dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 5,175,262 lekë, i bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime këto në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1.Rekomandimi:Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa për të njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” konstatohet se nuk është kontabilizuar vlera 5,846,966 lekë e cila i përket investimeve në proces. Objekt i investimit “Rikonstruksion i banesave të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore”, për vlerën 5,846,966 lekë është kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” veprim i cili ka nënvlerësuar llogarinë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe mbivlerësuar llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” për vlerën 5,846,966 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën .2.3, faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” konstatohet se janë kontabilizuar tre aktive me emërtimin “Rikonstruksion lulishte nr.1” me kosto historike 299,400 lekë, “Rikonstruksion lulishte nr.2 Grabian” me kosto historike 398,246 lekë dhe “Lulishte tregu javor” me kosto historike 1,856,026 lekë. Regjistrimet e mësipërme kanë mbivlerësuar llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” për vlerën 2,553,672 lekë dhe kanë nënvlerësuar llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në vlerën 2,553,672 lekë. Referuar Standardit Kombëtar të Kontabilitetit “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pikat 2, 10 dhe 21, dhe Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, aktivet duhej të klasifikoheshin në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”.*(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3 faqet 39- 58 të Raportit të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 2,553,672 lekë me kosto historike për aktivet, “Rikonstruksion lulishte nr.1”, “Rikonstruksion lulishte nr.2 Grabian”, “Lulishte tregu javor” së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur, duke e pakësuar si aktiv nga llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe duke e kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në datën 31.12.2023 në vlerën 2,041,469 lekë. Kjo vlerë e regjistruar në këtë llogari i përket aktiveve që administrohen nga Agjencia e Ndërmarrjes Komunale e cila është ndërmarrje varësie e Bashkisë Divjakë. Në kundërshtim me SKK Nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Jomateriale” pika 43 dhe 44 përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajta, Agjencia e Ndërmarrjes Komunale ka regjistruar investimet që ka kryer ndër vite për mbjelljen e pemëve si aktive të llogarisë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”. Investime e kryera duhet të kapitalizoheshin në vlerën e aktivitetit të llogarisë

213 sipas aktivitetit përkatës sepse kemi përmirësim dhe rritje të vlerës së aktivitetit dhe jo krijim të ri aktiviteti i cili mund të regjistrohet në llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”.

Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe 211 “Pyjet, Plantacionet” nuk janë kontabilizuar tokat, trojet dhe terrenet që me VKM i janë transferuar Bashkisë Divjakë dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogarit 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të kryejë zbatimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

10.2 Rekomandimi: Drejtorja e Buxhetit dhe Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 2,041,469 lekë me kosto historike për aktivet, e kontabilizuara në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione”, duke pakësuar aktivet nga llogaria 211 “Pyje, Plantacione” dhe duke e kontabilizuar në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ana e Bashkisë Divjakë nuk janë kontabilizuar detyrimet në vlerën 389,620,451 lekë me burim financimi nga granti, pavarësisht se për këto detyrime nga ana e operatorëve ekonomik janë lëshuar fatura tatimore përkatëse të protokolluara në Bashkinë Divjakë. Referuar kontratave të investimeve, likuidimi i këtyre kontratave është parashikuar të kryhet në disa periudha buxhetore. Vlera e pakontabilizuar 389,120,451 lekë është parashikuar të likuidohen gjatë vitit 2024. Konkretisht detyrime që i përkasin faturave të lidhura me projekte investimi si mëposhtë:

Detyrimet për objektin e investimit “Blerje binderi dhe asfaltim i rrugëve urbane” përbërë nga faturat me nr.338-532 të periudhës 01.01.2023-31.12.2023 me vlerë 35,316,864 lekë.

Detyrimet për objektin e investimit “Blerje transformatori dhe paisje mbrojtëse për kabinën elektrike për godinat e Bashkisë” përbërë nga 2 fatura tatimore të periudhës 01.01.2023-31.12.2023 me vlerë 958,464 lekë.

Detyrimet për objektin e investimit “Blerje çakëll” përbërë nga fatura tatimore të periudhës 01.01.2023-31.12.2023 me vlerë 5,615,702 lekë.

Detyrimet për objektin e investimit “Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësitë Administrative Remas Loti I” përbërë nga faturat me nr.94-276 të periudhës 01.01.2023-31.12.2023 me vlerë 347,729,421 lekë.

Si rezultat llogaria 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to” është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 389,620,451 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin Nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore

në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Bashkia Divjakë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e duhura për paraqitjen reale të llogarisë 401-408, duke kontabilizuar vlerën 389,620,451 lekë me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

12. Gjetje nga auditimi: Gjatë periudhës 2006-2021 sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nëpërmjet VKM në Bashkinë Divjakë janë transferuar 2,496 pasuri. Në Bashkinë Divjakë me VKM nr. 449, datë 19.07.2006 janë transferuar 723 pasuri, me VKM Nr. 49, datë 31.01.2018 janë transferuar 21 pasuri, me VKM Nr. 316, date 02.06.2021 janë transferuar 22 pasuri .

Në NjA Tërbuf me VKM nr.280, datë 06.04.2011 janë transferuar 926 pasuri. Në Nj.A Gradishtë me VKM nr.948, datë 02.09.2009 janë transferuar 290 pasuri, me VKM nr.431, datë 04.07.2012 janë transferuar 4 pasuri. Në Nj.A Remas me VKM nr.575, datë 28.05.2009 janë transferuar 313 pasuri. Në Nj.A Grabian me VKM nr.727, datë 01.07.2009 janë transferuar 197 pasuri.

Nga pasuritë e transferuara 61 pasuri janë pajisur me çertifikatë pronësie, 471 pasuri janë të pajisura me çertifikatë përdorimi dhe 1964 pasuri nuk janë pajisur me çertifikatë pronësie.

Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Divjakë nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezulton i papërditësuar. Veprime këto në kundërshtim me neni 37 i ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 58-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandim: Bashkia Divjakë të marrë masa për të krijuar një sektor të posaçëm për kadastrën, si pjesë të strukturës organike, me qëllim realizimin e detyrave për hartimin dhe përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme të bashkisë, përfshirë ish-komunat, aktualisht njësi administrative. të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie

Brenda datës 31.12.2024

13. Gjetje nga auditimi: Llogaria 4342 “Të tjera operatione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 74,455,722 lekë dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është paraqitur në vlerën 53,406,144 lekë. Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” e cila është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 21,049,578 lekë në kundërshtim me udhëzimin Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 38-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit, Bashkia Divjakë të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e saktë të llogarisë nr.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”

Me mbylljen e PF të vitit 2024

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se me urdhër Nr.363, datë 30.11.2023 të Titullarit të Bashkisë Divjakë është ngritur Komisioni i Asgjësimit/Tjetërsimit të aktiveve të vlerësuara për jashtë përdorimit nga komisionet e inventarizimit të Bashkisë Divjakë.

Komisioni i asgjësimit të aktiveve ka mbajtur procesverbalin me Nr.1839 prot, datë 13.03.2024.

Me vendimin Nr.40, datë 12.02.2024 për tjetërsimin dhe nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi është miratuar vendimi për aktivet si më poshtë:

Të miratoj daljen jashtë përdorimit të aktiveve të trupëzuara me vlerë 14,053,189 lekë e cila përbëhet nga rrethime, mure të dëmtuara. Drejtoria e Financës nuk ka dërguar në Këshillin Bashkiak 1(një) relacion për aktivet e dëmtuara në vlerën 14,053,189 lekë për miratim por ka çregjistruar nga kontabiliteti këto aktive në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 ‘Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik’ pika 120.

14.1Rekomandim: Bashkia Divjakë, Drejtoria e Financës të ngrejë 1(një) grup pune për rivlerësimin e aktive të hequra nga kontabiliteti dhe ti dërgojë Këshillit të Bashkisë Divjakë relacion për gjendjen e tyre me qëllim vendimmarrjen për këto aktive.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua nga ana e Bashkisë Divjakë janë shpenzuar 3,803,429 lekë për vendime gjyqësore. Vlera 3,803,429 lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 nga Bashkia Divjakë, për zbatimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur vendime të reja gjyqësore. Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60. (*Më hollësisht trajtuar në nënpikën 1, faqe 15-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen e çështjeve gjyqësore, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.I. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Divjakë në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ASHK Lushnje janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi.

Nga auditimi konstatohet se detyrimi për taksën e infrastrukturës në datën 01.01.2023 është në vlerën 22,765,991 lekë dhe përbëhet nga 603 debitorë. Pagesa për detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2023 janë në vlerën 7,917,645 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 2,624,421 lekë dhe detyrimet progresive në datë 31.12.2023 janë në vlerën 17,472,767 dhe përbëhet nga 279 debitorë. Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Divjakë për periudhën ushtrimore nuk ka njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që institucioni të jetë drejtuar ASHK-së Dega Lushnje, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore. Veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale”, të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar me vlerë 17,472,767 lekë ndaj 279 personave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuar se detyrimet progresive për taksa dhe tarifata vendore për abonentë familjarë/privatë në datën 01.01.2023 paraqiten në vlerën 481,903,308 lekë. Pagesa për detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2023 janë në vlerën 33,090,399 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 84,831,610 lekë dhe detyrimet progresive në datë 31.12.2023 janë në vlerën **533,644,519 lekë**. Detyrimet progresive në datën 31.12.2023 janë të kontabilizuara. Borxhi tatimor përbehet nga:

-Detyrime nga abonentët familjarë në vlerën **494,088,579 lekë**

-Detyrime nga biznese në vlerën **39,555,247 lekë** i përket 299 bizneseve

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 25-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e të ardhurave vendore në bashkëpunim me drejtoritë e tjerë të Bashkisë Divjakë, si Drejtoria e Aseteve, Drejtoria e Planifikimit Zhvillim Territorit, Drejtorinë Juridike, Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë Financës, të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **533,644,519 lekë** për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se në territorin e Bashkisë Divjakë për vitin ushtrimor 2023 kanë ushtruar aktivitetin 14 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i dosjeve fizike të subjekteve u konstatua se gjatë vitit 2023, 13 subjekte kanë rinovuar licencën. Subjektet e hidrokarbureve janë pajisur me licencë me afat 1 vjeçar për të cilën kanë kryer pagesën. Referuar dokumentacionit në dosje këto subjekte të cilat janë pajisur me licenca më afat 1 vjeçar nuk kanë dorëzuar dokumentacion e kërkuar referuar VKM Nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e

procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. Subjektet janë pajisur me licenca për tregtim pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre në kundërshtim me VKM Nr.970.

Sipas të dhënave, rezulton se subjekti “M.” ShPK, me NUIS K....L, është pajisur me licencë 5 vjeçare nga data 11.02.2020 - 10.02.2025, si dhe ka kryer pagesën e licencës në shumën 200,000 lekë në datë 28.09.2021 dhe pagesë në datë 10.10.2023 shuma 200,000, gjithsej në shumën 400,000 lekë, duke mbetur debitorë për shumën 600,000 lekë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 27-39, të Projekt Raportit të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Bashkia Divjakë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 600,000 lekë për subjektin “M” Shpk.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit të KLSH, dhe lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Divjakë, fillimin ose jo i procedurave për masë disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale të punës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT